

PROBLEMET ENDEMIKE TË TENDERIMIT DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE



Problemet endemike të tenderimit dhe menaxhimit të kontratave

Prishtinë, dhjetor 2023


Autore: Leorentë Alija

Ekipi i hulumtuesve: Valmir Ilazi, Ebru Zborça, Arber Kabashi

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Përkrahur nga:



PËRMBAJTJA

1. Lista e shkurtesave	5
2. Përmbledhje ekzekutive	6
3. Metodologjia.....	8
4. Procesi i monitorimi dhe menaxhimit të kontratave.....	9
5. Faza e (para) tenderimit.....	10
5.1. (Mos)hartimi i specifikimet teknike të detyrueshme	10
5.1.1. Komuna e Deçanit	12
5.1.2. Komuna e Dragashit.....	13
5.1.3. Komuna e Ferizajt	13
5.1.4. Komuna e Glogocit.....	13
5.1.5. Komuna e Gjakovës.....	13
5.1.6. Komuna e Gjilanit.....	14
5.1.7. Komuna e Kaçanikut	14
5.1.8. Komuna e Kamenicës.....	14
5.1.9. Komuna e Klinës.....	15
5.1.10. Komuna e Pejës	15
5.1.11. Komuna e Podujevës.....	15
5.1.12. Komuna e Prishtinës	16
5.1.13. Komuna e Prizrenit.....	16
5.1.14. Komuna e Rahovecit.....	16
5.1.15. Komuna e Suharekës.....	17
5.1.16. Komuna e Shtimës	17
5.1.17. Komuna e Vitisë	17
5.1.18. Komuna e Vushtrrisë	17
6. Faza e tenderimit	18
6.1. Inicimi i aktiviteteve të paplanifikuara	18
6.2. Kriteret diskriminuese dhe favorizuese në Dosjen e Tenderit dhe Njoftim për Kontratë	19
6.3. Shkurtimi i afateve për pranimit të tenderëve	24
6.4. Profesionalizmi në vlerësimin e tenderëve	27
6.5. Gjetjet tjera në fazën e tenderimit të aktiviteteve	29
7. Menaxhimi i kontratave.....	32
7.1 Aspektet formale të menaxhimit të kontratës	32
7.2 Ekzekutimi i pagesave në kundërshtim me ligjin.....	35
7.3 Siguria e ekzekutimi të kontratës.....	36
7.4 Gjetjet nga monitorimi në terren i implementimit të kontratave	37
8. Gjetjet kryesore.....	52
9. Rekomandimet.....	54
10. ANEKS: Tenderët e monitoruar	56

I. Lista e shkurtesave

AK - Autoritet Kontraktues

OE - Operator Ekonomik

DNPDF - Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve

PMK - Plani për Menaxhimin e Kontratës

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

LPP - Ligji për Prokurim Publik

RrP - Rregullat për Prokurim Publik

OShP - Organi Shqyrtues i Prokurimit

KVK - Kushtet e Veçanta të Kontratë

2. Përmbledhje ekzekutive

Procesi i prokurimit është thelbësor për qëndrueshmërinë e menaxhimit financiar si dhe ofrimin efektiv të shërbimeve publike. Momenti i planifikimit të aktivitetit, inicimi, deri tek nënshkrimi i kontratës dhe menaxhimi i kontratës, janë procese mjaft të rëndësishme që kërkojnë ligjshmëri, konsistencë, profesionalizëm dhe integritet. Ndër të tjerash, proceset e prokurimit rezultojnë edhe në performancën e një AK përgjatë një viti fisikal nëse ka arritur të përmbushë çdo objektiv të po atij autoriteti. Tutje, AK-të, duhet të sigurojnë që i tërë procesi i prokurimit të ketë transparencë dhe trajtim të drejtë dhe të barabartë duke përfshirë zbatimin e të gjitha veprimeve dhe vendimeve.

Qëllim i këtij raporti është të vlerësoj, fazën e paratenderimit me theks të veçantë specififikimet teknike të detyrueshme duke analizuar në detaje hartimin e rregullave dhe përmbushjen e këtij obligimit ligjor nga ana e komunave, fazën e tenderimit të aktivitetëve të prokurimit, duke identifikuar shkeljet eventuale të cilat mund të shkaktohen apo janë shkaktuar. Kontribut i përgjithëshëm i këtij hulumtimi i atribuohet menaxhimit të kontratës dhe proceseve përcjellëse të saj më qëllim të përmirësimit, menaxhim i cili përfundon ciklin dhe ndihmon që mallrat dhe shërbimet të dorëzohen mirë sipas specifikimeve.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se dymbëdhjetë (12) nga tetëmbëdhjetë (18) tender të monitoruar në tetëmbëdhjetë (18) AK në fazën e inicimit të akvitetëve të prokurimit nuk kanë hartuar specifikime teknike të detyrueshme sipas nenit 28 të Ligjit për Prokurim Publik, ndërsa komunat pohojnë se informatat rreth specifikimeve teknike të detyrueshme gjinden në paramasë dhe listë të çmimeve, gjersa shpesh herë ato janë të paqarta, diskriminuese dhe të pa definuara kështu duke cënuar cilësinë dhe efikasitetin e prokurimit. Dobësitë tjera që janë evidentuar gjatë fazës së monitorimit janë: Inicimi i aktivitetëve të paplanifikuara, mos respektimi i parimit të profesionalizmit nga AK-të për vlerësimin e tenderëve, kriteret diskriminuese dhe jo proporcionale gjatë vlerësimit të tenderëve si dhe shkurtimi i afeteve për pranimin e tyre.

Ndërsa, sa i përket menaxhimit të kontratave në tetëmbëdhjetë (18) komunat e monitoruara të gjeturat tregojnë se AK-të vazhdojnë të pranojnë furnizim, shërbim apo punë të cilat nuk janë realizuar konform kushteve të kontratës. Përveq kësaj, siguria e ekzekutimit të kontratës luan një rol kyq në përmbushjen e plotë të saj, kështu që pesë (5) nga trembëdhjetë (13) komunat e monitoruara sigurinë e ekzekutimit nuk e kanë në përputhje me kërkesat ligjore, pra e cila ka skaduar pa përfunduar ende kontrata. Ndërsa, si pjesë e pashmangshme për të kompletuar në tërësi menaxhimin e kontratës, INPO ka aplikuar edhe vizitën në terren, përkatësisht në vendin e ekzekutimit të kontratave, si indikator për monitorimin e zbatimit të kontratave. Vizitat në terren kanë dëshmuar se komunat ekzekutojnë pagesa pa përfunduar punët si dhe ekzekutojnë pagesa edhe përkundër që furnizimet, shërbimet apo punët i kanë pranuar në kundërshtim me kontratë dhe paramasë, apo nuk i kanë pranuar fare. Monitorimi në terren ka shpërfaqë gjithashtu edhe cilësinë e dobët të punëve të realizuara, lënie e punëve në gjysmë, mos respektim i specifikeve të pozicioneve në paramasë apo edhe ndryshimi i tyre.

Vlen të thekësohet se mos korigjimi i dobësive në sistemet e prokurimit në Kosovë përmes kornizës ligjore gjithëpërfshirëse, procedurave efektive të monitorimit dhe të auditimit për të siguruar harmonizimin me rregulloret, termat dhe kushtet standarde të kontratave, transparencën e përmirësuar dhe kapacitetet për të përmirësuar avancimin dhe rekrutimin e njerëzve me aftësi profesionale në prokurim do të vazhdojë të shkaktojë pasoja të rënda në realizimin e projekteve të sukseshme.

Në fund të raportit, INPO ka hartuar rekomandime konkrete, me qëllim të adresimit dhe përmirësimit të shkeljeve dhe zbatimit të rregullave gjatë zhvillimit procedurave të prokurimit dhe fazës së menaxhimit të kontratës për të gjitha palët të përfshira në këtë proces.

Në përgjithësi, INPO rekomandon që komunat të hartojnë specifikimet teknike të detyrueshme duke përcaktuar në detaje furnizimin, shërbimin apo punën e caktuar, të iniciojnë tender në përputhje me planin e prokurimit, të mos vendosin kritere diskriminuese dhe vlerësimi i tenderëve të jetë profesional dhe konform kërkesave dhe kritereve ligjore.

Tutje, menaxherët e kontratave të jenë njohës të fushës me të cilën ka të bëjë kontrata dhe të njëjtit të mos ngarkohen me kontrata të shumta në mënyrë që pastaj të rrezikohet menaxhimi cilësor i tyre dhe afati i implementimit të saj mund të stërgjatet për shkak të zvarritjes së procedurave.

Komunat të mos ekzekutojnë pagesa pa pranuar furnizimin, shërbimin dhe punën e caktuar, si dhe të mos pranojnë përmbushje të kontratës në kundërshtim me termat dhe kushtet e saj.

3. Metodologjia

INPO me qëllim që të hartoj një raport përmbajtësor dhe në përputhje me objektivat e projektit ka përdorur metodologji të kombinuar të hulumtimit. Hulumtimi përfshinë tetëmbëdhjetë (18) komuna, përkatësisht komunat: Deçan, Dragash, Ferizaj, Glogoc, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Për shkak të mungesës së komunikimit me komunat veriore, respektivisht Komuna e Leposaviqit dhe Mitrovicës së Veriut, INPO nuk ka mundur të shtrijë monitorimin e procesit të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave në këtë pjesë, përkundër që të njejtat janë fokus i monitorimit.

Fillimisht janë përzgjedhur nga dy tender për secilën komunë të monitoruar, ku një është monitoruar nga momenti i inicimit të tenderit deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, ndërsa një tender tjetër, përkatësisht kontratë është monitoruar nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri tek përmbushja e plotë. Tenderët, përkatësisht kontratat e përzgjedhura për monitorim janë tender të ashtuquajtur me “flamuj të kuq”, përkatësisht aktivitete dhe kontrata të cilat potencialisht mund të kenë shkelje ligjore dhe procedurale gjatë inicimit, dhënies dhe menaxhimit të kontratës.

Metodologjia e ndjekur për monitorim të specifikimeve teknike - Nëpërmjet platformës e-prokurimit janë shkarkuar Dosjet e Tenderit dhe analizuar Aneks I i kësaj dosje nëse Autoritetet Kontraktuese kanë përfillur dispozitat ligjore të cilat i referohen specifikimeve teknike për hartimin e tyre. Në rast se të njejt janë hartuar, INPO përmes kërkesave për qasje në dokumente publike ka kërkuar autorin e specifikimeve teknike nga një Autoritet Kontraktues i cakuar.

Metodologjia e ndjekur për monitorimin e tenderëve nga iniciimi deri në dhënie të kontratës - Nëpërmjet platformës e-prokurimi janë shkarkuar dokumentet e nevojshme për monitorim, ndërsa dokumentet e munguara janë siguruar nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike. Pas kompletimit të dokumenteve është analizuar në përpikmëri respektimi i procedurave ligjore lidhur me procesin e prokurimit për tenderin e caktuar. Hulumtimi ka filluar qysh me analizimin e asaj se aktiviteti i iniciuar a është në plan të prokurimit, a ka mjete financiare AK për zhvillimin e projektit në fjalë, respektimi i afateve kohore për pranimit të tenderëve dhe për vlerësim të ofertave, profesionalizmi dhe deklarata nën betim e anëtarëve të komisioneve vlerësuese, e kështu me radhë.

Pjesë e pashmangshme e hulumtimit ka qenë edhe analizimi i kriterëve të dhënies së kontratës përkatësisht a aplikojnë komunat kriterë shumë të larta, diskriminuese apo favorizuese në dosje të tenderit si dhe është analizuar ajo se a rekomandohet dhe shpërblehet me kontratë OE me çmimin ekonomikisht më të favorshëm apo më të lirë, varësisht se cilin kriter e ndjekë AK. Në këtë pjesë është analizuar edhe profesionalizmi në vlerësimin e tenderëve, posaçërisht në aspekt të kualifikimit të anëtarëve të komisioneve vlerësuese dhe në kualitetin e vlerësimit të tyre.

Metodologjia e ndjekur për tenderët nga nënshkrimi i kontratës deri në përmbushje të plotë të saj - Edhe tek pjesa e menaxhimit të kontratave, metodologjia e sigurimit të

dokumenteve ka qenë e njëjtë. Monitorimi i kontratave është përbërë nga dy faza. Në fazën e parë janë hulumtuar dokumentet, përfshirë këtu PMK-në, raportet e menaxherëve të kontratave, pagesat dhe pranimi përfundimtar i furnizimeve, shërbimeve apo punëve. Ndërsa, në fazën e dytë INPO ka praktikuar viziten në vendin e ekzekutimit të kontratës, për ta parë se a ekzekutohet kontrata në bazë të kushteve kontraktuese, me cilësi të duhur dhe vërtetimi i asaj se AK a ka marr furnizimin, shërbimin ose punën në përputhje me pagesat e ekzekutuara.

Në fund, drafti i këtij raporti është dërguar tek të gjitha komunat e monitoruara për komente eventuale. Komentet e dhëna nga komunat janë pjesë e këtij raporti.

4. Procesi i monitorimi dhe menaxhimit të kontratave

Procesi i prokurimit dhe menaxhimi i kontratave janë procese të rëndësishme të cilat zhvillohen konform legjislacionit primar dhe skondar, respektivisht Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe legjislacionin sekondar Rregullat për Prokurim Publik. Për të pasur akoma më të qartë se si duhet të veprohet konform udhëheqjes së procedurave të prokurimit publik në përgjithësi KRPP ka hartuar edhe Udhëzuesin e Prokurimit Publik.

Procesi i prokurimit apo faza e tenderimit ka të bëjë me zhvillimin e procedurave të prokurimit nga planifikimi i prokurimit e deri në dhënie të kontratës. Planifikimi i prokurimit, inicimi i aktiviteteve mbi bazen e një planifikimi të mirëfillt, është një nga hapat më të rëndësishëm, specifikisht në këtë fazë përgatiten kërkesat dhe specifikat e dosjes së tenderit, pikërisht këtu do të varet se sa autoriteti kontraktues zbaton rregullat për prokurim dhe shmang shkeljet ligjore të cilat eventualisht mund të ndodhin. AK për ta zhvilluar fazen tenderuese në frymen e ligjit zgjedh procedurën e duhur, nuk shkurton afatet kohore, vendosja e njerëzve kompetent për vlerësimin e ofertave, si dhe tajton në mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme çdo kërkesë të OE-ve të cilët eventualisht nuk pajtohen me vlerësimin e tenderëve e të cilat mund të deponojnë ankesë pranë një organit kolegial siç është Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Duke qenë se vazhdimisht i referohemi kornizes ligjore për sa i përket transparencës në shpenzimin e paras publike, ngjashëm ndodh edhe me fazën e dytë e cila fillon me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon në momentin e pranimit të furnizimit, shërbimit apo punës së kontraktuar nga AK. Ky proces është tejet kompleks nëse nuk respektohen obligimet ligjore deri në implemenimin e plotë të kontratës dhe është po aq i thjeshtë nëse udhëhiqet mbi parimet e e mos-diskriminimit, transparencës dhe llogaridhënies.

Nënshkrimi i kontratës është kurorëzim i udhëheqjes së procedurave, e cila dëshmon se kanë përfunduar procedurat ankimore lidhur me tenderin e caktuar, në të njëjtën kohë shënon edhe hyrjen në një proces shumë delikat i cili është menaxhimi i kontratës. Me nënshkrimin e kontratës nga ZKA emërohet një menaxher të kontratës,¹ i njejtë është i obliguar që para fillimit të

¹ Për më shumë shih nenin 70.5 të RrPP-së, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf.

implementimit të kontratës të hartoj PMK, në të njëjtën kohë edhe OE emëron një menaxher për kontratën në fjalë. Hartimi i PMK-së është detyrë e menaxherit të emëruar nga AK, mirëpo i njëjti duhet të jetë në pajtim edhe me menaxherin e OE-së, kjo vërtetohet me nënshkrimin e planit nga dy menaxherët.²

Menaxheri i kontratës është përgjegjësi kryesor për zbatimin e kontratës, i njëjti sipas vendimit të ZKA është përgjegjës për implementimin e tërësishëm të kontratës. Çdo pagesë, punë shtesë, ndryshim apo amandamentim i kontratës duhet të aprovet nga menaxheri i kontratës. Menaxheri është përgjegjës edhe për cilësinë e punëve, përmbushjen e kontratës sipas paramasës dhe afateve kohore të përcaktuara dhe shumë çështje tjera të përcaktuara me ligj³.

Menaxhimi i kontratës përfundon me përfundimin e furnizimit, shërbimit, apo punës së kontraktuar, përkatësisht me raportin përfundimtar të përmbushjes së kontratës. Menaxhimi gjithashtu mund të përfundoj edhe në rast të ndërprerjes së kontratës për shkak të arsyeve të ndryshme ligjore, si dhe në rastet kur kontrata nuk përfundon brenda afateve të parapara me kontratë dhe palët kontraktuese nuk janë marr vesh që ato afate të zgjaten apo vazhdoen.

5. Faza e (para) tenderimit

AK-ve përpara inicimit të procesit të një prokurimi dhe udhëheqjen e procedurave të prokurimit, ligji i përcakton edhe disa detyra të tjera të cilat shpiten deri tek iniciimi i një procedure. “Ndërtimi” i një procedure të prokurimit fillon qysh prej një planifikimi të duhur, dizajnimin e specifikimeve teknike të detyrueshme, hartimin e projektit ekzekutiv tek aktivitetet për punë si dhe vendosja e kriterëve në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë të cilat për më tepër duhet të përputhen me natyrën e tenderit dhe ndër të tjerash nuk diskrimojn apo favorizojnë një OE. Duke parë anashkalimin e specifikimeve teknike si element kyq në procedurat e prokurimit, INPO ka trajtuar me seriozitet të lartë specifikimet teknike dhe të gjitha gjetjet për tetëmbëdhjet (18) komuna i gjeni të listuara në vijim.

5.1. (Mos)hartimi i specifikimet teknike të detyrueshme

Gjatë kohës së përgaditjes së këtij raporti, INPO me qëllim të pasqyrimin të saktë të gjendjes reale në udhëheqjen e procedurave të prokurimit, fokus të veçant i ka kushtuar hulumtimin dhe analizimin të specifikimeve teknike të detyrueshme. Korniza ligjore është e qartë për sa i përket specifikimeve teknike të detyrueshme, qoftë ajo primare apo sekondare. Sipas LPP, përkatësisht nenit 28, “Autoriteti kontraktues do ti parashtrijë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit”. Duke u mbështetur në këtë dispozitë ligjore, INPO ka analizuar të gjithë tenderët e monitoruar nëse AK-të në dosjen e tenderit kanë hartuar specifikimet teknike të detyrueshme.

² Neni 81, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

³ Shih, përgjegjësitë dhe detyrat e menaxherit të kontratës, neni 70.23 dhe 70.24 të RrPP-së, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

Ndërsa, mungesa e specifikimeve teknike është gjetje e vazhdueshme në Raportet e Progresit kjo nënkupton se përkundër theskimit të nevojës së përmisimit të gjendjes edhe në raportet ndërkombëtare sa i përket hartimit të tyre, kjo mbetet një pikë e papërmisueshme në praktikë nga AK-të.

Ndër të tjerash, ndër të pakta specifikime teknike të cilat hartohen nga ana e AK-të duhet të jenë ekuivalente me natyrën e tenderit, madje specifikimet të cilat i drejtohen vetëm një produkti sipas ligjeve në fuqi janë të ndaluara. Se specifikimet duhet të jenë të paanshme konfirmojn edhe parimet e rifreskuara të SIGMA-s për administratën publike, ku në mesin e parimeve listohet një mori rregullash për specifikime teknike siç janë: specifikime teknike të qarta, të përshtatshme dhe të paanshme, kriteret të qarta si dhe jodiskriminuese për përzgjedhje cilësore të OE-së⁴. Tutje, sipas të gjeturave të INPO-s, gjatë monitorimit të punës së OShP për nëntë (9) mujorin e punës, nga 748 ankesa të deponuara në OShP brenda kësaj periudhe, INPO ka gjetur se në njëmbëdhjetë (11) vendime, AK-të janë obliguar të bëjnë përmisimin e Dosjes së Tenderit, kjo ngase ankesat e OE-ve, kanë qenë pikërisht për kriteret e paraqitura⁵.

Për më tepër, specifikime teknike dhe kriteret e dhënies së tenderit, janë dy çështje shumë të ndryshme të cilat ngatërrohen në praktikë. Madje, ato as nuk pasqyrohen qartë gjatë analizimit të tyre. Ligji për Prokurim Publik çështjen e specifikimeve teknike trajton ndaras nga kriteret e dhënies së kontratës. Sipas nenit 69 të po këtij ligji, listohen qartazi aftësit teknike dhe profesionale për dhënien e një tenderi. Kjo nënkupton, se në dokumentin B05 - Njoftim për Kontratë, listohen kriteret të cilat kërkon AK që të përmbushet nga një OE i caktuar, me qëllim të shpërblimit me kontratë që do të thotë se në një dokument të tillë nuk mund të listohen specifikimet teknike, por të njejtat paraqiten në Aneksin I të Dosjes së Tenderit.

Në kuptim të kësaj, INPO ka bërë analizimin e të gjitha aktiviteteve të monitoruara në tetëmbëdhjetë (18) komuna, ku është pasqyruar gjendja reale në praktike nga aspekti i përmbushjes së obligimeve të detyrueshme sa i përket specifikimeve teknike.

Të gjeturat e hulumtimit të INPO-s tregojnë nga tetëmbëdhjetë (18) tender të monitoruar në tetëmbëdhjetë (18) AK në fazën e inicimit të akvitetëve të prokurimit dymbëdhjetë (12) prej AK-ve nuk kanë hartuar specifikime teknike të detyrueshme. Në gjashtë (6) AK të cilat kanë hartuar specifikime teknike, INPO ka kërkuar nga këto autoritete autorin/en e specifikimeve teknike dhe në këtë rastë nga përgjigjet e kërkuara për gjashtë (6) tender në gjashtë (6) komuna, INPO ka pranuar përgjigje vetëm nga Komuna e Kamenicës dhe e Shtimës, për autorin e specifikimeve teknike, komuna e Gjakovës dhe e Prizrenit janë përgjigjur se njësia e kërkesës është hartues, ndërsa Komuna e Pejës dhe Podujevës kanë refuzuar të përgjigjen. Për më tepër, gjatë hulumtimit, INPO në disa raste ka hasur edhe në hezitim të përgjigjes kjo “për shkak të përdorimit nga operatorët

⁴ Për më shumë Shih Parimet e SIGMA-s për Administratën Publike, i qasshëm në <https://www.sigmaweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration-2023-edition-ALB.pdf>

⁵ Për më shumë rreth punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për periudhën janar-shtator 2023, shih raportin “Shqyrtimi i Korrupsionit në Prokurim Publik”, të publikuar nga INPO, i qasshëm në: https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Raporti-i-monitorimit-te-OShP-se_06.12.2023-INPO.pdf

ekonomik”, kurse, në një (1) rast INPO ka gjetur se hartues i specifikimeve teknike, përkatësisht listës së çmimeve [dokument i cili sipas AK-ve po konsiderohet specifikim teknik] është vet operatori ekonomik fitues.

Kjo analizë përmbanë edhe të gjetura variable kur në disa komuna, Autoritetet Kontraktuese ngatërrojnë në masë të madhe specifikimet teknike dhe listën e çmimeve, LPP këto dokumente i trajton si çështje të ndara, çka do të thotë se këto specifikime paraqiten vetëm përmes listës së çmimeve. Meqë, për tetëmbëdhjetë (18) tenderëve të monitoruar në dymbëdhjetë (12) prej tyre nuk janë hartuar specifikimet teknike, INPO ka kërkuar sqarime shtesë nga secili autoritet për secilin tender se pse nuk janë hartuar ato. Sipas përgjigjeve të pranuar nga AK-të, rezulton se arsyeja kryesore e mungesës së specifikimeve teknike të detyrueshme në Ankesin I të Dosjes së Tenderit është se të njëjtat paraqiten vetëm përmes listës së çmimeve/paramasës apo edhe përgjigje të atilla sikurse “nuk e kemi aplikuar pasi e kemi në kërkesat teknike dhe paramasë”. Për më tepër, përgjigjet e tilla nuk përkojnë me kërkesat ligjore. Madje, neni 4, paragrafi 1.63 përshkruar në mënyrë të qartë se specifikimi teknik i detyrueshëm përkufizon karakteristikat e kërkuara të një materialit, produktit ose furnizimit që i mundëson llojit të punës⁶.

Tutje, INPO ka gjetur se për aktivitetet për punë, përkundër kërkesës ligjore që në mënyrë mandatore të bëhet përshkrimi i projektit ekzekutiv, e njëjta nuk përfillet në praktikë. Nga shtatë (7) tenderë të monitoruara për punë, përkundër këtij obligimi ligjor, vetëm një (1) nga AK-të ka përfillur kërkesën ligjore për përshkrim të specifikimeve në një tender për aktivitetet për punë. Kjo nënkupton se AK-të, nuk japin vëmendjen e duhur sa i përketë detajzimit të punëve të cilat do të duhej të realizohen konform ligjit, por AK-të si përshkrim vendosin vetëm “projektin ekzekutiv për palët e interesuara”.

5.1.1. Komuna e Deçanit

Njoftimi për kontratë për tenderin “Ndërtimi i fshatit turistik Podi i Gështenjave-Faza e II”⁷ ishte bërë më 21.02.2023. Tenderi i zhvilluar sipas procedurës së hapur me vlerë të parashikuar të kontratës 246,015.00€. Ndryshe nga vlera e inicimit, sipas planifikimit përfundimtar të prokurimit për vitin 2023, vlera e parashikuar e këtij tenderi ishte 100.000,00€⁸. Mirëpo, për këtë tender Komuna e Deçanit, bazuar në Dosjen e Tenderit nuk ka hartuar specifikimet teknike të detyrueshme. Në Aneksin I thuhet se “referohu paramasës dhe parallogarisë”. Ndërsa, në listen e çmimeve listohen vetëm punët të cilat obligohet OE fitues të përfundoj sipas listimit të çmimeve përfundimtare për implementimin e tërësishëm të kontratës.

Në një analizë më të detajuar të paramasës, INPO ka gjetur se hartues/autor i listës së çmimeve është vet GOE fitues, INGconcept SH.PK; ARFA GROUP SH.PK. me vlerë totale 226,545.00 euro. Dhënia e kësaj kontrate është në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit për Prokurimin Publik,

⁶ Shih Ligjin për Prokurim Publik, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

⁷ Për më shumë shih aktivitetin e prokurimit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2391126

⁸ Shih planin përfundimtar të prokurimit të Komunes së Deçanit

i cili në mënyrë të qartë ndalon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në përgatitjen apo dhënien e ndihmës në hartimin e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti kontraktues dhe se këto veprime përbëjnë konflikt të pastër të interesit. INPO, në këtë rast ka kërkuar sqarime nga komuna e Deçanit se si është e mundur që OE fitues të jetë autor i listës së çmimeve. Nga Zyra e Prokurimit kanë theksuar se: “ju njoftojë se njësia kërkuese na e dërgon paramasën dhe paralogarinë e ne nuk jemi në dijeni se kush e ka punuar paramasën”.

5.1.2. Komuna e Dragashit

Komuna e Dragashit për tenderin “Rregullimi i rrugës dhe infrastrukturës përcjellëse në rrugën Qupino në fshatin Brod” të inicuar sipas vlerën së planifikuar për këtë aktivitet, 20,000.00 euro, nuk ka konsideruar neni 28 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 19 të Rregullores për Prokurim Publik për hartimin e specifikimeve teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit për aktivitetin e inicuar me datë 16.02.2023⁹. Për më tepër, për këtë tender nuk ka pasur kriter në Njoftimin për Kontratë nga Komuna e Dragashit për kapacitetin ekonomik dhe financiar për tu përmbushur nga ana e OE-ve të cilat konsiderohen si dëshmitë e përshtatshmërisë dhe kualifikimit të tenderuesve sipas rregullave ligjore.

5.1.3. Komuna e Ferizajt

INPO ka monitoruar aktivitetin e prokurimit “Ritenderim II Mbarsimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve clostridiale”, të udhëhequr nga Komuna e Ferizajt. Përveq listës së çmimeve dhe kriterëve të paraqitura në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, ky AK nuk ka hartuar specifikimet teknike për kontratën të llojit shërbim.

5.1.4. Komuna e Glllogocit

Komuna e Glllogocit për aktivitetin “Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit” të inicuar pa planifikim me vlerë të parashikuar 150.000,00 euro, nuk ka hartuar specifikimet teknike sipas nenit 28 të LPP. Komuna e Glllogocit për këtë tender, përshkrimin e detyrave dhe specifikimeve të tjera e ka realizuar vetëm në listën e çmimeve. Ndërsa, sipas komunes për specifikimet teknike të cilat nuk janë hartuar dhe nuk figurojnë në dosjen e tenderit, sipas përgjigjes së komunës z. Bujar Plakiqi është hartues i tyre.

5.1.5. Komuna e Gjakovës

Ndryshe nga AK-të e lartpërmendura, Komuna e Gjakovës, për analizimin e konsumit të energjisë apo më sakt për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e konsulencës për përmirësim të shërbimeve në Komunën e Gjakovës” me vlerë të parashikuar 90,000.00 ka hartuar specifikimet teknike sipas kuadrit ligjor duke përshkruar në mënyrë më të detajuar kërkesat e obligueshme të

⁹ Shih Dosjen e Tenderit: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2307356

kontratës. Mirëpo, specifikime teknike nga ky AK duken më shumë si specifikime kozmetike. Komuna e Gjakovës nuk ka marrë parasysh nenin 19, përkatësisht paragrafi 19.3 të Rregullores për Prokurim publike “*Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit*”. Në këtë drejtim, INPO ka pytur Komunen e Gjakovës kush është hartues i specifikimeve teknike, të njejtë janë përgjigjur Drejtoria e Shërbimeve Publike.

5.1.6. Komuna e Gjilanit

“*Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan Ri Tender*”, aktivitet pune i udhëhequr nga Komuna e Gjilanit dhe zhvilluar sipas procedurës së hapur ka marrë epilogun e kontratës së nënshkruar pa specifikime teknike të detyrueshme. Madje, Komuna e Gjilanit në dosjen e tenderit thekson se duhet referuar listës së çmimeve dhe se projektin ekzekutiv mund ta tërhiqeni pranë AK-së me USB. Kësisoj, Komuna e Gjilanit ka shkelur nenin 28, paragrafi 10 i Ligjit për Prokurim Publik i cili thot se “*Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit.*” Madje, të njejtën përgjigje kanë ofruar edhe INPO-s, sa i përketë mos hartimit të specifikimeve teknike, që projekti ekzekutiv është në dispozicion për palët e interesuara.

5.1.7. Komuna e Kaçanikut

INPO ka gjetur se ngjashëm sikurse AK-të e lartpërmenduar, as Komuna e Kaçanikut nuk ka hartuar specifikimet teknike për tenderin “*Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriqimit publik në rrugë Murat Lika , Strazhë*”. Kësisoj, AK ka bërë shkelje të nenit 28 të LPP duke mos hartuar këto specifikime teknike dhe të njejtat janë paraqitur vetëm përmes përshkrimit të çmimeve. INPO i bën me dije Komunes së Kaçanikut, se duhet respektuar LPP karshi hartimit të këtyre specifikave dhe se LPP specifikimet teknike dhe listen e çmimeve i parasheh si çështje të ndara.

5.1.8. Komuna e Kamenicës

Ndër të paktat AK të cilat kanë arritur të hartojnë specifikimet teknike të detyrueshme është edhe ajo e Komunes së Kamenicës. Për tenderin *Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe Fshatra Shipashnicë, Karaqevë, Busavatë, Kopërnice, Koretin dhe Topanice-Ritenderim 2* dhe vlerë të parashikuar të kontratës 338,925.07, ky AK ka hartuar specifikimet teknike të detyrueshme. Mirëpo, referuar dosjes të tenderit të njejtat nuk janë të paraqitura përmes Ankesit I të Dosjes së Tenderit, në të njejtin thuhet “*referoju dokumenteve të të bashkëngjitura në dosje të tenderit*”. Kësisoj, të njejtat, pra specifikimet teknike, pjesa grafike, analiza statike dhe specifikimi i armatures gjinden tek shtojca së bashku me dokumentet tjera relevante. Në këtë rast, INPO ka drejtuar pyetje se kush është hartues i specifikimeve teknike për këtë projekt. Sipas komunikave zyrtare me komunën, hartues i specifikimeve teknike është kompania projektuese, ndërsa njëzia e kërkesës është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Inspektimeve. Tutje, vlen të theksohet se të gjitha informacionet sa i

përket specifkimeve teknike janë siguruar vetëm përmes komunikimeve zyrtare, për të cilat nuk ekziston ndonjë vendim paraprak caktimin e autorit për hartimin e tyre.

5.1.9. Komuna e Klinës

Për tenderin “*Hartimi i projekteve zbatuese*” të inicuar dhe zhvilluar pa planifikim nga Komuna e Klinës, nuk ka hartuar specifkimet teknike të detyrueshme. Në këtë drejtm, INPO ka kërkuar sqarime nga kjo komunë se cilat janë arsyet e mos hartimit të specifkimeve teknike. Sipas komunikimeve zyrtare që i kemi zhvilluar me këtë komunë thuhet se: “*nuk e kemi praktikuar, pasi specifkimet e detajuara gjinden në paramas*”. Kësisoj, INPO ka analizuar edhe paramasen e cila sipas komunes “*konsiderohet specifkimi teknik*” dhe ka gjetur se për hartimin e projekteve nuk janë të parapara as m² për projektet për të cilat konsiderohet hartimi i tyre. Madje, të njejtat janë llogaritur “paushall”.

5.1.10. Komuna e Pejës

INPO ka monitoruar tenderin “*Turizmi i aventures ne Komunen e Pejes*” për të cilin Komuna e Pejës ka paraparë që të shpenzojë hiç më pak se 264,530.00 euro për një aktivitet të pa përfshirë në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2023. Mirëpo, përkundër kësaj për këtë aktivitet Komuna e Pejës ka hartuar specifkimet teknike duke pasqyruar në mënyrë më të qartë projektin për të cilin ka paraparë të shpenzojë këto mjete¹⁰. Kësisoj, INPO ka pyetur komunen se kush është hartuesi i këtyre specifkimeve teknike, të njejtit kanë refuzuar të përgjigjen dhe për këtë çështje INPO ka parashtruar ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi¹¹.

Përtej kësaj, në formularin B05 i njohur si Njoftimi për Kontratë, tek kushtet për pjesëmarrje, përkatësisht; kapaciteti teknik dhe profesional në kërkesën 5 është kërkuar “*Deklarat e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifkimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K*”, mirëpo INPO-s i është refuzuar qasja në këto dokumente.

Ndërsa, lista e çmimeve nga Komuna e Pejës është publikuar në formatin Word, kjo bie në kundërshtim me **Njoftimin e KRPP-së të datë 01.11.2022**, i cili takstativisht kërkon që ky dokument të publikohet vetëm në formatin EXCEL.

5.1.11. Komuna e Podujevës

Më 13.03.2023, Komuna e Podujevës kishte inicuar tenderin “*Ngritja e infrastrukturës së turizmit*”, të paraparë sipas planit të prokurimit 2023 në vlerë prej 200,000.00 euro sipas procedurës së hapur, ndërsa e njejtat nuk është paraparë fare në Ligjin për Buxhetin të vitit 2023.¹² Komuna, për këtë aktivitet kishte hartuar specifkimet teknike, mirëpo jo në mënyrën e paracaktuar, që do të thotë se nuk përfshin të gjitha detajet e përshkrimit teknik të këtij projekti. Komuna e Podujevës,

¹⁰ Shih Dosjen e Tenderit: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2654690

¹¹ Shih Njoftimin për Kontratë: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2654690

¹² Shih Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2023: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68589>

duke qenë në mesin e komunave të cilat kanë hartuar specifikimet teknike, INPO ka drejtuar pyetje për autorin e këtyre specifikimeve teknike, por komuna ka heshur në këtë rast.

Hezitimi i autoriteve kontratuese në publikimin e emrave të personave të cilët hartojnë specifikimet teknike kërkon vëmendjen dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve nga ana e të gjitha institucioneve, sepse një informacion i tillë nuk mund të konsiderohet sekret.

5.1.12. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës, për aktivitetin “Demontimi , Transporti dhe deponimi i Azbestit nga objektet publike” të inicuar më 23.03.2023 në vlerë prej 100.000,00 euro të zhvilluar sipas procedurës së hapur nuk ka përcaktuar specifikimet teknike të detyrueshme në Dosjen e Tenderit, përkatësisht Ankesin I. Në këtë aneks, thuhet: “*Bashkangjitur gjeni ne e-prokurim do të gjeni tek dosja e tenderit edhe Specifikimin teknik*”. LPP është shumë i qartë për sa i përket hartimit të specifikimeve teknike.

Madje, në listën e çmimeve duke ju referuar udhëzimeve teknike të komunes në Dosjen e Tenderit, gjinden vetëm pesë pozicione të cilat nuk përcaktojnë në mënyrë të detajuar përshkrimin teknik të punëve. Duke qenë obligim ligjor dhe duke ditur rëndësinë e këtij tenderi Komuna e Prishtinës do të duhej të kishte parasysh përcaktimin e (i) masat mbrojtëse gjatë ekzekutimit të kontratës, duke ditur rrezikshmërinë e asbestit, (ii) mjetet për mbrojtje personale, (iii) si dhe vendet ku do të bëhet transportimi i asbestit. Këto janë vetëm tre (3) nga shumë specifikime të tjera teknike të cilat ky autoritet kontraktues do të duhej të kishte parasysh.

5.1.13. Komuna e Prizrenit

“*Hartimi i planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit*”, tender i udhëhequr nga Komuna e Prizrenit, përmban disa specifikime teknike të cilat asociojnë në një përshkrim të mangët të këtij aktiviteti. Në këtë rast, sikurse në çdo komunë tjetër, INPO ka pyetur se kush është hartues i këtyre specifikimeve teknike, nga Komuna e Prizrenit kemi pranuar këtë përgjigje: “*Specifikat tenderuese i kemi nxjerrë së bashku me drejtorinë për Emergjencë por për arsye të mundësisë së përdorimit nga operator të tjerë nuk mund të japim detajet*”¹³. Sipas përgjigjes së Komunes së Prizrenit, hartuesit e specifikimeve konsiderohen sekret.

Në specifikimet teknike Komuna e Prizrenit, për ti hartuar ato konform nenit 28 të LPP do të duhej të kishte parasysh ndarjen e detajuar ashtu siç kërkohet sipas ligjit. Kjo komunë nuk ka specifikuar në Dosjen e Tenderit (i) zonat se ku do të bëhet identifikimi i rreziqeve, (ii) paisjet të cilat do të përdoren, (iii) përshkrimin e planit se cilat janë pikat të cilat duhet të fokusohen¹⁴.

5.1.14. Komuna e Rahovecit

Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratën, Komuna e Rahovecisht për tenderin “*Mbikëqyrja e investimeve kapitale në komunën e Rahovecit – Ritenderim*”, e kishte bërë me datë 25.07.2023. Për

¹³ Përgjigje e siguruar nga Komuna e Prizrenit.

¹⁴ Shih Dosjen e Tenderit e qasshme: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2635182

këtë tender, kjo komunë i ka paraqitur specifikat teknike vetëm sipas listës së çmimeve, ndërsa në Ankesin I Të Dosjes së Tenderit, ku parashihet të bëhet përshkrimi më i detajuar i këtij tenderi figuron informacioni se “*specifikat teknike janë të bashkangjitura/pershkruara në paramasë*”¹⁵.

Kësisoj, INPO ka kërkuar më shumë informacion nga Komuna e Rahoveci për sa i përket specifikimeve teknike të këtij tenderi. Të njëjtat ani pse nuk janë të hartuara në Dosjen e Tenderit, sipas Komunes së Rahovecit “*Specifikimet teknike janë hartuar nga arkitektet dhe inxhinier të komunës, në bashkëpunim me USAID-in, me të cilët komuna ka bashkëpunim*”, duke mos dhënë informacione më të detajuara.

5.1.15. Komuna e Suharekës

Më 24.05.2023, kishte inicuar ritenderin “*Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen Skenderbeu - Suharekë-ritender*”. Për këtë ritender të zhvilluar sipas procedurës së hapur me kriterin çmimi më i lirë, Komuna e Suharekës nuk kishte hartuar specifikimet teknike sipas obligimeve të cilat derviojnë nga ligji. Madje, në dosjen e tenderit, përkatësisht Ankesin I ku parashihet hartimi i këtyre specifikimeve është vendosur lista e çmimeve¹⁶.

5.1.16. Komuna e Shtimës

“*Furnizim me farë hibride të misrit*” është tender i inicuar nga Komuna e Shtimes. Për këtë tender, komuna ka hartuar specifikimet teknike, duke përcaktuar sasinë, llojin dhe se të njëjtat duhet të përmbajnë deklaratën e prodhuesit në pajtim me Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në këtë drejtim, INPO ka pyetur komunën se kush ka hartuar specifikimet teknike për këtë tender dhe të njëjtit janë deklaruar se z. Bashkim Ahmeti, me profesion inxhinier i bujqësisë është hartues i specifikimeve teknike të detyrueshme.

5.1.17. Komuna e Vitisë

“*Hartimi i projekteve investive(kapitale) për komunën e Vitisë*”, është tender i inicuar nga Komuna e Vitisë dhe zhvilluar sipas procedurës së hapur në të cilin tender nuk gjenden specifikime teknike të detyrueshme fare. Komuna e Vitisë për këtë tender nuk ka hartuar fare këto specifikime teknike. Të njëjtat janë të paraqitura vetëm në listen e çmimeve të cilat AK-të po konsiderojn si specifikime teknike. Për shkak të mos hartimit të specifikimeve teknike, INPO ka pyetur komunën e Vitisë pse të njëjtat nuk janë të paraqitura në Ankesin I të Dosjes së Tenderit, sipas komunes “*të njëjtat janë të paraqitura vetëm në paramasë siç e kemi pranuar nga inxhinier dhe specifikimet teknike nuk janë hartuar në mënyrë të veçantë*”.

5.1.18. Komuna e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë është në mesin e pak komunave të cilat kanë hartuar specifikimet teknike të detyrueshme. Mirëpo, për tenderin “*Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës*”, të

¹⁵ Shih Dosjen e Tenderit, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2667678

¹⁶ Shih Dosjen e Tenderit, e qasshme në https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2609902

njejtat specifitime janë të paraqitura njësoj sikurse tek lista e çmimeve/paramasa. Komuna e Vushtrrisë ka kufizuar qasjen në dokumente publike për secilin dokument ndaj INPO-s, rrjedhimisht nuk kemi informacion se kush është hartues i specifitimeve teknike.¹⁷

6. Faza e tenderimit

Faza e tenderimit të aktiviteteve të prokurimit është proces i cili fillon nga momenti i planifikimit të prokurimit dhe përfundon në momentin e nënshkrimit të kontratës, respektivisht hyrja në obligime kontraktuale me një OE të suksesshëm. Të gjitha këto procedura udhëhiqen nga AK-të me persona zyrtarë kompetent në udhëheqjen të cilëve kërkohet profesionalizëm dhe integritet. Në kuadër të këtij procesi, saktësisht fazën e tenderimit të aktivitetit përfshihen: procedura që AK zgjedh për një aktivitet të caktuar, afatet kohore për pranim të tenderve, vendosja e personave me profesionalizëm të natyres së tenderit për vlerësim të ofertave, vlerësimi i ofertave brenda afateve të caktara kohore si dhe trajtimi i kërkesave për rishqyrtim nga OE-të të cilet janë të interesuar të marrin pjesë në tender. Në vazhdim do të gjeni gjetjet e INPO-s për sa i përket të gjithë procesit të inicimit të aktiviteteve të prokurimit.

6.1. Inicimi i aktiviteteve të paplanifikuara

Planifikimi i prokurimit si proces ligjor dhe procedural derivon nga legjislacioni primar dhe sekondar, respektivisht Ligji për Prokurimi Publik dhe Rregullore për Prokurim Publik. Të dy këto akte parashohin afatet ligjore për planifikim të prokurimi.

Kësisoj, secili AK “Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t’i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal”. Në këtë drejtim, planifikimi i prokurimit pasqyron efikasitetin dhe efektivitetin e një AK-je, nëse të njejtit kanë arritur përmbushjen e objektivave, ndërsa mos përfshirja e aktiviteteve në plan të prokurimi mund të qoj drejt dështimit të hapave tjerë procedurale gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit¹⁸.

INPO gjatë monitorimit të procesit ka analizuar dhe evdientuar tender të cilët janë inicuar, mirëpo të njejtit nuk janë të përfshirë në planet përfundimtare të prokurimit të secilit AK, ndërsa të dhënat i gjeni të paraqitura në tabelen si më poshtë.

Tenderët e inicuar pa planifikim		
Komuna	Tenderi	Numri i prokurimit
Ferizaj	Ritenderim II Mbarsimi artificial i lopëve	656-22-9727-2-I-I

¹⁷ **Sqarim:** Lidhur me këtë, INPO ka parashtuar ankesë në Agjencin për Informim dhe Privatësi për kufizim të qasjes në dokumente publike

¹⁸ Shih raportin e INPO-s, (Mos)Planifikimi i prokurimit <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/11/Raporti-MosPlanifikimi-i-Prokurimit-INPO.pdf>

	qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve clostridiale	
Glllogoc	Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit	611-23-1507-2-1-1
Gjakovë	Shërbimet e konsulencës për përmirësim të shërbimeve në Komunën e Gjakovës	632-23-3834-2-2-1
Gjilan	Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan Ri Tender	651-23-9254-5-1-1
Kaçanik	Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriqimit publik në rrugë Murat Lika, Strazhë	652-23-2430-5-2-1
Klinë	Hartimi i projekteve zbatuese	634-23-9571-2-2-1
Pejë	Turizmi i aventures ne Komunen e Pejes	635-23-9465-5-2-1
Shtime	Furnizim me farë hibride të misrit	617-23-1184-1-2-1
Vushtrri	Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës	VU644-23-8311-2-2-1

Tabela I: Tenderët e inicuar pa planifikim

Rezultatet e hulumtimit në tabelen I, tregojnë se nëntë (9) nga tetëmbëdhjetë (18) komunat e monitoruara kanë inicuar tender të paplanifikuar. Nëse krahasojmë gjetjet e INPO-s të vitit 2022 sa i përket planifikimit të prokurimit, atëherë dukshëm kemi një rritje të inicimit të aktiviteteve pa planifikim në komuna. Në vitin 2022 vetëm pesë (5) nga njëzet (20) komunat e monitoruara kanë inicuar tender të paplanifikuar, ndërkaq në vitin 2023 sipas ky numër është rritur në +4 komuna të cilët kanë inicuar aktivitete pa planifikim.

6.2. Kriteret diskriminuese dhe favorizuese në Dosjen e Tenderit dhe Njoftim për Kontratë

Kërkesat ligjore dhe parimet e prokurimit publik, në mënyrë decisive kërkojnë udhëheqjen e procedurave të prokurimit duke përfillur të gjitha dispozitat ligjore të cilat i dedikohen barazisë, jo-diskriminimit të operatorëve ekonomik dhe favorizim për disa të tjerë¹⁹. Favorizimi i një OE të caktuar vjen si rezultat i vendosjes së kriterëve të cilat konsiderohen shumë të larta, jo propocionale mandej në disa raste edhe jo valide. Ndërsa, vendosja e kriterëve të larta të cilat nuk ndërlidhen fare me natyren e tenderit janë të ndaluara sipas njoftimit KRPP-së nr. 88/19, të datës 22.11.2019. Në këtë rast, KRPP ka interpretuar nenin 69 të LPP, ku kërkon nga autoritetet kontraktuese që kriteret të cilat vendosen në një aktivitetet të caktuar të jenë relevante dhe në

¹⁹ Shih nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik, i qasshëm në: <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

përputhje me natyren e caktuar të tenderit, në të kundërtën çdo devijim jashtë saj nënkupton favorizim të një OE dhe diskriminim për një tjetër.

Sipas raportit vjetor të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik për vitin 2022, neni 7.3 i Ligjit për Prokurim Publik bën pjesë në mesin e neneve me numrin më të madh të intervenimeve të evidentuar me tridhjetë e shtatë (37) sosh, ndërsa për nenin 69, aftësitë teknike dhe profesionale, ku përfshihen kërkesat kualifikuese, certifikatat nga instituti për kontroll të cilësise, lista e mjeteve të punës e kështu me radhë, KRPP ka intervenuar në 163 raste në nivelin qendror dhe lokal²⁰. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara është formular i aprovuar nga KRPP përmes së cilit bëhet korrigjimi i gabimeve apo kritereve diskriminuese dhe favorizuese të cilat nuk ndërlidhen fare me natyren e tenderit. Përdorimi i këtij formulari vjen në shprehje si pasojë e intervenimeve apo reagimeve të OE-ve, nga AK-të dhe nga persona të tretë si monitorues të prokurimit publik, siç është edhe rasti i INPO-s.

INPO gjatë monitorimit të procesit të prokurimit në tetëmbëdhjetë (18) komuna ka evidentuar disa AK të cilat kanë vendosur kritere të larta, diskriminuese dhe jo proporcionale me natyren e tenderi dhe të njejtat janë paraqitur si në vijim.

Komuna e Ferizajt në tenderin “Ritenderim II Mbarsimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve clostridiale”, tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte kërkuar “Lejen nga AUV për importin e materialit gjenetik për dy vitet e fundit (2021-2022 duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) origjinal ose kopje të noterizuar, dhe të kete DUD doganor për importin e materoalit gjenetik të deshmohetme se paku tri leje për importin mbrenda ketyre dy viteve”. Ndër të tjerash kërkesë e Dosjes së Tenderit kishte qenë edhe “Materiali gjenetik i racave që do të përdoren për mbarsim artificial duhet të dëshmohet përmes katalogut zyrtar i cili vertetohet me leter përcjellese (përgjigje) nga AUV për indeksin meritore të demave të ketyre racave 1. Simental 2. Holstain i zi 3. Limousi 4. Blue belgian 5. Montbiliard - Materiali gjenetik i përdorur duke u bazuar në standardet e fertilitetit të fares së demave duhet të ketë TMI mbi 120. Në Holandë emrohet gNVI. Në Danimark, Suedi dhe Finlande emrohet si gNTM. Në Spanjë si giCO. Në Gjermani, Austri GZW GKZ RZG dhe në Francë gISU etj²¹.

Vendosja e kritereve diskriminuese dhe favorizuese ishte konfirmuar me **Vendimin nr. 491/22** nga OShP të datës 09.12.2022²², pas ankesës së OE pretendent për të qenë pjesëmarrës në këtë tender. OShP kishte kërkuar largimin e kërkesave favorizuese, duke i konsideruar si diskriminuese

²⁰ Shih Raportin Vjetor të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik për vitin 2022, I qasshëm në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20vjetor%202022.pdf>

²¹ Shih Njoftimin për Kontratë, i qasshëm në https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2534993

²² Shih Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit të qasshme në: https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?_RequestVerificationToken=lz5ldN0PIn9ykjZkAEVFX6fY-AHVrU7LIWXhN9ZL7jCrGgWlz5L7D3ijAN3sj-cOErxcrh0uaDWB3GXjXxYr44YjfiMXW5K4uoPUoBIMCGkI&ProcurementNumber=656-22-9727-2-I-I&ContractingAuthorityId=&EconomicOperatorId=

sepse aktiviteti është shërbim dhe në asnjë formë nuk është e pranueshme që të kërkohet nga të gjithë ofertuesit të jenë të pajisur me leje të materialit gjenetik, ndërsa Komuna e Ferizajt, me formularin e korrigjimeve të gabimeve të datës 13.04.2023, pas paraqitjes së 5 kërkesave për rishqyrtim dhe 3 ankesave në OShP, kishte larguar kriteret diskriminuese dhe favorizuese në këtë tender.

Kritere diskriminuese dhe favorizuese, INPO ka gjetur edhe tek Komuna e Gjilanit, në aktivitetin “Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan Ri Tender”, aktivitet në të cilin ka rezultuar vetëm një ofertues dhe rrjedhimisht fitues i tenderit. Komuna e Gjilanit, për këtë tender tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte kërkuar që operator ekonomik të ketë të përfunduara me sukses kontrata të ngjashme me natyrën e aktivitetit në vlerë prej 3,000,000.00 €, ku prej tyre duhet të ketë se paku një Kontrate apo reference në lëmin e rregullimit të shtretërve të lumenjëve ose kolektorëve. Si rezultat i kësaj kërkesë diskriminuese, dy OE kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe të njëjtat janë refuzuar si të pabazuara nga AK²³.

Komuna e Kaçanikut në tenderin “Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriqimit publik në rrugë Murat Lika , Strazhë” tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar mjetet e kompanisë - Kamiona vet hkarkues me peshe bartese min 10m3 . së paku dy (2). -Kamion me kran me peshe bartese se paku 10 ton. Kamionet me korpë se paku një (1), -Eskavator, së paku një (1) - Cilinder 2 deri 5 ton, së paku një (1). Kjo kërkesë kufizon OE-të që mund të ofertojnë për këtë tender, për pasojë një nga arsyet në këtë tender që është shpallur i papërgjegjshëm operatori ekonomik është mungesa e dëshmive për këto mjete²⁴.

Kriter driskriminues INPO ka gjetur edhe në tenderin e Komunes së Kamenicës për tenderin “Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra Shipashnicë,Karaqevë,Busavatë,Kopërnice, Koretin dhe Topanicë-Ritenderim 2”. Tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar nga operatorët ekonomik që të dorzojnë listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, **të projekteve të ngjajshme (Kolektor ,kanalizime dhe ujesjellesa)** të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate. INPO vlerëson se ky kriter nuk është kërkesë e legjislacionit për prokurim, përkatësisht nenin 69, paragrafi 6.2 të LPP-së. AK nuk duhet të kufizoj konkurrencën, duke kërkuar kontrata me emër specifik siç janë kolektor, kanalizime dhe ujësjellsa.

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, është formular i aplikuar nga Komuna e Klinës, në tenderin e hartimit të projekteve zbatuese, me anë të të cilit janë larguar kriteret diskriminuese dhe favorizuese nga Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontratës, pas paraqitjes së tre (3) kërkesave për rishqyrtim nga operatorët ekonomik. Komuna e Klinës kishte kërkuar (i) një numer të madh të ISO, (ii) listat e stafit më përvojë shumë të gjatë, (iii) paisje të cilat nuk janë relevante me natyrën e tenderit, andaj komuna pas paraqitjes së

²³ Shih Vendimet ndaj Kërkesave për Rishqyrtim të qasshme në, https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2764670

²⁴ Shih Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2354156

kërkesave për rishqyrtim me datë 18.09.2023, kishte larguar kriteret diskriminuese dhe favorizuese.

Komuna e Prishtinës në tenderin “Demontimi , Transporti dhe deponimi i Azbestit nga objektet publike”, tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte aplikuar kriteret tek kapaciteti teknik dhe profesional në kundërshtim me nenin 69. Respektivisht, kjo komunë kishte kërkuar një numër të konsiderueshëm të ISO standardeve dhe ndër të tjerash edhe “Gjashtë (6) punëtor të certifikuar për punë me azbest sipas normave ISO 29993”, kriter i cili është larguar me formularin për korrigjimin e gabimeve të datës 03.04.2023.

Kritere shumë të larta dhe jo proporcionale, INPO ka gjetur edhe në tenderin “Mbikëqyrja e investimeve kapitale në komunën e Rahovecit – Ritenderim” të udhëhequr nga Komuna e Rahovecit. Ndër të tjerash, kjo komunë tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte kërkuar një listë të gjatë të stafit profesional të operatorit ekonomik siç janë: (i) Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune në menaxhimin e projekteve të natyrës së kontratës min. 8 vite pas diplomimit, (ii) Inxhinier i Diplomuar ose Bachelor në Inxhinieri Softverike (IT), me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në Cisco Certified Network Associate (CCNA), (iii) Ekspert i pajisur me Certifikata rreth organizimit, menaxhimit dhe sigurisë në kantiere të ndërtimit, min. 3 vjet përvojë pune; I.I.I. Ekspert i licencuar për testimin e ujësjesve sipas Standardit EN 805 dhe një numër i konsideruar i ISO standardeve ndërkombëtare. Si rezultat i këtyre kriterëve në këtë tender ka ofertuar vetëm një operator ekonomik me të cilin është nënshkruar edhe kontrata.

Komuna e Vitisë, bën pjesë në mesin e komunave të cilat kanë vendosur kriteret diskriminuese dhe favorizuese në tenderin “Hartimi i projekteve investive(kapitale) për komunën e Vitisë”. Kjo komunë tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte kërkuar (i) kontrata në shumën minimum sa Vlera e planifikimit të projektit për hartime; në fushën e projektimit të rrugëve me dy korsi, struktura të urave dhe mure mbrojtëse, projektim të trotuareve, kanalizime ose ujësjes, dhe Renovime të objekteve dhe të ngjashme, (ii) Menaxheri i projektit Inxhinier i dip. ose master i ndërtimtarisë, dhe të ketë menaxhuar së paku dy (2) projekte në pozitën e Menaxherit të Projektit në Lëmin e Projektimit, rrugë, objekte dhe Strukturave, (iii) OE duhet të posedoj një dron profesional për matje fotogrametrike, i cili duhet të ketë të integruar mundësinë e matjeve GPS RTK PPK. Si rezultat i kriterëve të larta, favorizuese dhe diskriminuese të vendosura në Dosjen e Tenderit, në këtë tender ka ofertuar vetëm një operator ekonomik. Madje, sipas Raportit Vjetor të Punës së KRPP-së, Komuna e Vitisë zë vendin e parë si AK me numrin më të madh të intervenimeve nga ky institucion²⁵.

Komuna e Vushtrrisë në tenderin “Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës”, tek kapaciteti teknik kishte kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të disponon me objekët hapësirë - zyre për ofrimin e shërbimeve e cila duhet të jetë në qytetin e Vushtrrisë”. Ligji për Prokurim Publik përcakton në mënyrë të qartë se AK-të janë të ndaluara të hartojnë specifikime teknike të cilat

²⁵ Për më shumë shih Raportin Vjetor të Punës së KRPP-së për vitin 2022, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20vjetor%202022.pdf>

favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operator ekonomik dhe në të njëjtën kohë duhet të paraqiten kritere të cilat mundësojnë konkurrencë në mes të operatorëve ekonomik. Për shkak të kriterit diskriminues, INPO ka kërkuar nga kjo komunë që të largoj këtë kriter dhe i njëjti është larguar me formularin për korrigjim të gabimeve të datës 28.08.2023²⁶.

Mirëpo, këta nuk janë tenderët e vetëm në të cilët janë paraqitur kriteret diskriminuese, joproporcionale dhe jo valide në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për kontratë. INPO në mënyrë sistematike bën monitorimin e tenderve dhe kriteret e paraqitura dhe si pasojë e kësaj përmes reagimeve të brendshme kemi kërkuar largimin e këtyre kriterëve të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e tenderit. Ndërkaq të gjitha rastet e ndërhyjes i gjeni të listuara në tabelen në vijim.

Reagimet e INPO-s lidhur me kërkesat shumë të larta, jo proporcionale, diskriminuese dhe jo valide në dosje të tenderëve			
Komuna	Titulli i tenderit	Numri i prokurimit	Rezultati
Gjilan	Hartimi i projekteve për ndërtime të larta në Komunën e Gjilanit	651-23-4059-2-1-1	Pas reagimit të INPO-s, Komuna e Gjilanit ka përmisuar kriteret e Dosjes së Tenderit, duke larguar ISO standartet të cilat nuk përputhen me natyrën e tenderit
Glllogoc	Zgjerimi dhe ndertimi i sheshit Fehmi dhe Xheve LLadrovci Drenas	611-23-2223-5-1-1	Pas reagimit dhe rekomandimit të INPO-s, Komuna e Glllogocit ka përmisuar kriteret e larta dhe joproporcionale.
Shtime	Rregullimi i ndriçimit publik	617-23-7696-1-2-1	Pas reagimit të INPO-s, Komuna e Shtimes ka larguar ISO standartet të cilat nuk përputhen me natyrën e tenderit.
Vushtrri	Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës	VU644-23-8311-2-2-1	Pas reagimit të INPO-s, Komuna e Vushtrrisë ka larguar kriterin diskriminues dhe favorizues.

Tabela 2. Reagimet e INPO-s lidhur me kërkesat shumë të larta, jo proporcionale, diskriminuese dhe jo valide në dosje të tenderëve

Në tabelen më lartë, vërehet se INPO gjatë hulumtimit ka ndërhyrë në katër (4) raste në katër (4) komuna për shkak të kriterëve diskriminues, favorizues dhe joproporcionale. Kësisoj, në

²⁶ Për më shumë shih reagimin e INPO-s, i qasshëm në <https://inpo-ks.org/pas-rekomandimit-te-inpo-s-komuna-e-vushtrrise-largon-kriterin-diskriminues-dhe-favorizues-nga-dosja-e-tenderit/?fbclid=IwAR38gVF6ThnlN4lMOXosl5sHGOux7QE0oz5M4VWEqHcULpQYMv5RBzzBVXo>

të gjitha rastet të cilat ka paraqitur reagim INPO, kanë rezultuar me përmirsim të kriterëve të cilat nuk përputhen me natyrën e tenderit.

6.3. Shkurtimi i afateve për pranim të tenderëve

Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, kriter për udhëheqjen e procedurave konform kërkesave ligjore, kërkohet edhe vendosja e afatit për pranimin e tenderve. Legjislacioni në fuqi për prokurim publik, parasheh një numër të konsiderueshëm të neneve të cilat i dedikohen afateve për pranimin e tenderëve për të gjitha llojet e tenderve dhe procedurat, duke filluar nga kalkulimi i tyre [neni 5], rregullat e posaçme për caktimin e afateve kohore [neni 44], rregullat e posaçme për afatet kohore për pranim të tenderve për njoftim paraprak [neni 45], si dhe [neni 4] shpjegon në detaje rregullat e posaçme për shkurtim të afateve për pranim të tenderve. Ligji ka paraparë të gjitha këto dispozita ligjore për afatet e pranimit të tenderve për AK-të në mënyrë që OE-të të kenë kohën e duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës për tenderin e caktuar.

Kësisoj, INPO vazhdimisht në raportet e saj ka paraqitur komunt të cilat kanë shkurtuar afatet ligjore, kësisoj të njejtat vazhdojnë të qëndrojnë të papërmirsueshme përkitazi me afatet e përcaktuara për pranim të tenderve. INPO edhe këtë vit në fazën e monitorimit të procesit ka gjetur raste kur komunat kanë shkurtuar këto afate, në kundërshtim me ligjin dhe pa asnjë arsye bindëse të cilat ndikojnë në vështirësim të procesit të paraqitjes së ofertave nga ana OE-ve, madje disa prej tyre mund të humbasin tenderin për shkak të kohës së shkurtër.

Shkurtimi i afateve pa një ndonjë arsye bindëse në disa raste lë të nënkuptohen mundësinë e favorizimit të një operatori ekonomik dhe diskriminimin të tjerëve të cilët eventualisht janë të interesuar të marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit të caktuar. Kësisoj, në vazhdim janë paraqitur të gjitha rastet e shkurtimit të afateve të cilat INPO i ka gjetur dhe vlerëson i të kundërligjshme.

Komunat të cilat kanë shkurtuara afatet për pranim të tenderëve			
Komuna	Tenderi	Afatet e shkurtuara	Arsyet
Ferizaj	Ritenderim II Mbarsimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve clostridiale	Nga së paku 40 ditë, në 16 ditë	Ritenderim II
Glllogoc	Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit	Nga së paku 40 ditë në 21 ditë	Kjo proceduë shpallët me procedurë të shkurtuar për arsye së komuna ka nevojë për perfaqsim ligjorë .

Gjakovë	Shërbimet e konsulencës për përmirësim të shërbimeve në Komunën e Gjakovës	Nga së paku 20 ditë në 11 ditë	Bazuar në ligjin me nr.06 L-079, për Eficiencë të Energjisë, neni 6, paragrafi 2, 5, 8, citohet që Komunitat e Kosovës, çdo vit dhe jo më vonë se data 30 prill të vitit aktual. Kuvendi është i obliguar të miratojë dhe dorëzojë raportin tek AKEE
Gjilan	Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan Ri Tender	Nga së paku 40 ditë në 21 ditë.	Arsyetimi nga Njësia Kërkuese është se për arsye se duhet të kryej një pjesë të rrethoj se murit mbrojtje të FSK , fillimisht, dhe pastaj njëkohësisht pritet të organizohen edhe shtrirja e rrjetit të kolektoreve të ujërave të zeza dhe për shkak që mos të humbet shumë kohë për mundësinë e realizimit të këtij projekti
Kamenicë	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra, Shipashnicë, Karaqevë, Busavatë, Kopërnice, Koretin dhe Topanice-Ritenderim 2	Nga së paku 20 ditë, në 11 ditë.	Kjo procedurë është shpallur 2 herë dhe ka deshtuar për shkak të vlerës së vogël të planifikuar për këtë projekt .
Klinë	Hartimi i projekteve zbatuese.	Nga së paku 20 ditë në 11 ditë.	Duke e parë që është anuluar dy herë radhazi për arsye të vendimit të OSHP-se Drejtoria e Urbanizimit e ka parë të arsyeshëm zhvillimin e procedurës së shpejtuar për projektin “Hartimi i projekteve zbatuese. Mos hartimi i projekteve paraprake sjellë probleme të vazhdueshme në terren për arsye se rrjedhin edhe punë të paplanifikuara që nuk mund të parashikohen vetëm në paramasë.
Pejë	Turizmi i aventurës në Komunën e Pejës	Nga së paku 20 ditë në 13 ditë.	Ky A.P është në bashkëfinancim me MAPL-

			ne me daten 05.07.2023 eshte nenshkruar marveshje bashkpunimi mes MAPL-se dhe KK Peje per inicimim e kesaj procedure dhe realizimi i keti projekti eshte me afat te pershpejtuar per arsyeje qe realizimi i puneve ka te beje me specifika te cilat varen shum nga parashikimet e motit
Suharekë	Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen Skenderbeu - Suharekë-ritender	Nga së paku 40 ditë në 23 ditë.	Pasi aktiviteti i ka qen i publikuar me pare dhe tani kemi Ri-tender andaj edhe po e bejme shkurtimin e afatit
Viti	Hartimi i projekteve investive(kapitale) për komunën e Vitisë	Nga së paku 40 ditë në 15 ditë.	AK bazuar ne nenin 46.1 të LPP-s ka vendos shkurtimin afatit te pranimit të dosjeve. Për arsye te nevojës se zhvillimit te projekteve për komunën,per arsye te mos arritjes se afateve te kerkuara, me qellim te lidhjes se një kontrate si domosdoshmëri për hartimin e projekteve kapitale për komunën oer fillimin e zhvillimit te tyre (implementimit)

Tabela 3. Komunat të cilat kanë shkurtuara afatet për pranim të tenderëve

Nga tabela më lartë vërejm se AK-të vazhdojnë të shkurtojnë afatet ligjore për pranim të tenderëve në mënyrë krejt të kundërligjshme duke mos përfillur kërkesat ligjore, kësisoj nëntë (9) nga tetëmbëdhjetë (18) komunat e monitoruara kanë shkurtuar afatet ligjore për pranim të tenderëve. Për më teper, arsyetimi si “Bazuar në ligjin me nr.06 L-079, për Eficiencë të Energjisë, neni 6, paragrafi 2, 5, 8, citohet që Komunat e Kosovës, çdo vit dhe jo më vonë se data 30 prill të vitit aktual.Kuvendi është i obliguar të miratoj dhe dorëzoj raportin tek AKEE”, dhe inicimi i procedurës së prokurimit me datë 25.04.2023 mund të rezultoj vetëm në favorizim të një OE të caktuar nga Komuna e Gjakovës. Tutje, edhe Komuna e Pejës arsyetimin se “aktiviteti i prokurimit është bashkëfinancim me MAPL në bazë të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me këtë

institucion me datë 05.07.2023 dhe inicimi i procedurës, saktësisht pas gjashtëdhjetë e tre (63) ditëve rezultoi në po të njëjtin konkluzion. Ngjashëm ndodh edhe me Komunen e Klinës dhe me arsyetimin e saj për shkurtime të afateve ligjore në mënyrë të kundërligjshme, kjo sepse Komuna e Klinës aktivitetin për hartim të projekteve zbatuese, e ka inicuar tek në muajin shtator të vitit 2023, apo nëntëdhjetë e gjashtë (96) ditë pas anulimit të aktivitetit të parë.

Shkurtimi i afateve ligjore për pranimin e tenderëve është në kundërshtim me rregullat për prokurim publik, i cili ndikon direkt në numrin e OE-ve që do të ofertojnë. Në këtë rast AK-të duhet të sigurojnë të paraqesin kriteret të cilat mundësojnë konkurrencen në mes të OE-ve.

6.4. Profesionalizmi në vlerësimin e tenderëve

Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) bazuar në nenin 59 të LPP me anë të vendimit, për secilin aktivitet të prokurimit të inicuar formon komisionin për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për tenderin e caktuar²⁷. Ky proces njëherësi konsiston në procesin më kompleks të fazës së tenderimit, i cili përcillet me numër të madhë shkëlqesh. Tutje, përveq legjislacionit primar edhe ai sekondar për prokurim publik trajton me seriozitet të lartë vlerësimin e ofertave. Për më tepër, ky legjislacion dispozitë të veçantë i kushton profesionalizimit të antarëve të komisionit vlerësues dhe se përvoja dhe njohurit e tyre duhet të lidhen me natyrën e tenderit²⁸.

Kësisoj, INPO duke monitoruar aktivitetet e prokurimit, ka analizuar edhe Vendimet për Formimin e Komisionit vlerësues, vendim i cili duhet të jetë publik në platformën e eprokurimit e në të ralla raste publikohet dhe i njëjti për secilin antarë/e të këtij komisioni vlerësues përcjellat me nga një deklaratë nën betim për secilin prej tyre. Përkatazi me këto vendime, INPO ka analizuar përbërjen e komisioneve dhe në vazhdim gjeni (mos)përputhjen e kualifikimeve të antarëve të komisionit vlerësues me natyrën e tenderit.

(Mos)përputhja e kualifikimeve të antarëve të komisionit vlerësues me natyrën e tenderit			
Komuna	Aktiviteti	Anëtarët e komisionit vlerësues	Profesioni
Gjilan	Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan Ri Tender	<i>Flokart Klaiqi</i>	<i>Ekonomist</i>
		<i>Astrit Sherifi</i>	<i>Ekonomist</i>
		<i>Bujar Sefiu</i>	<i>Shkolla e mesme</i>
Kamenicë	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra, Shipashnicë, Karaqevë, Busavatë, Kopërnice, Koretin dhe Topanice-Ritenderim 2	<i>Mehmet Thaqi</i>	<i>Inxhinier i arkitektures</i>
		<i>Arif Skoverqani</i>	<i>Jurist</i>
		<i>Nexhat Rexhepi</i>	<i>Jurist</i>
Pejë	Turizmi i aventurës në Komunen e Pejës	<i>Sami Gashi</i>	<i>Ekonomiste</i>

²⁷ Shih Ligjin për Prokurim Publik, nenin 59, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

²⁸ Për më shumë shih, neni 39.1 i RrPP, e qasshme në https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

		<i>Mimoza Anadulli</i>	<i>Ekonomiste</i>
		<i>Januz Hajzeraj</i>	<i>Shkenca politike</i>
Podujevë	Ngritja e infrastrukturës së turizmit	<i>Fidan Salihu</i>	<i>Inxhinjerisë Mekanike</i>
		<i>Kujtim Zhitia</i>	<i>Inxhinjer për Emergjencë</i>
		<i>Xhevrie Beqiri</i>	<i>Ekonomiste</i>
Prizren	Hartimi i planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit	<i>Jakup Kastrati</i>	<i>Inxhinier i diplomuar i bujqësi</i>
		<i>Ymer Berisha</i>	<i>Profesor i shkencave të biologjisë</i>
		<i>Fari Krasniqi</i>	<i>Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë</i>
Rahovec	Mbikëqyrja e investimeve kapitale në komunën e Rahovecit – ritenderim	<i>Jetmir Ukaj</i>	<i>Arkitekt</i>
		<i>Gërmia Gashi</i>	<i>Juriste</i>
		<i>Egzon Thaqi</i>	<i>Ekonomist</i>
Shtime	Furnizim me farë hibride të misrit	<i>Mursel Salihu</i>	<i>Administratë publike</i>
		<i>Safet Ibrahim</i>	<i>Ekonomist</i>
		<i>Armend Imeri</i>	<i>Jurist</i>
Viti	Hartimi i projekteve investive(kapitale) për komunën e Vitisë	<i>Mifail Azizi,</i>	<i>Ekonomist</i>
		<i>Qendrim Kajolli</i>	<i>Jurist</i>
		<i>Arben Jakupi,</i>	<i>Shkolla e mesme</i>

Tabela 4. (Mos)përputhja e kualifikimeve të antarëve të komisionit vlerësues me natyrën e tenderit

Duke ditur procedurat e prokurimit si natyrë komplekse, udhëheqja e tyre duhet të bëhet me integritet., andaj, vlerësimi i tenderve është crucial në dhënien e kontratës. Tabela më lartë tregon qartazi për secilën komunë se vlerësimi i tenderëve dhe profesioni i personave të cilët kanë marrë pjesë në vlerësim të ofertave, nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e tenderit, madje në disa raste tabela tregon që personat me shkollën e mesme marrin pjesë në këtë proces, ani pse kontratat e dhëna i përkasin vlerave të mëdha.

Aktivitetet për punë, hyn në mesin e aktiviteteve të cilat janë vlerësuar nga personat të cilët me profesion janë ekonomist, kjo ka ndodhur në Komunën e Gjilanit, Pejës dhe Podujevës. Si rezultat i vlerësimit jo të duhur të ofertave duke mos ditur natyrën e tenderit mund të shkakohen pengesa gjatë ndërtimit të ciklit të prokurimit të cilat shpesh deri në papërgjegjshmërinë e OE-së fitues.

Si rezultat i vlerësimit të gabuar të ofertave, OShP në nivel qendror dhe lokal ka kthyer njëqind e shtatëdhjetë e një (171) lëndë në ri-vlerësim²⁹. Në të njëjtën linjë, me raportin vjetor të OShP-së për vitin 2022 janë edhe të gjeturat e INPO-s për sa i përket ri-vlerësimit të ofertave për vitin 2023. Sipas të gjeturave të INPO-s, gjatë monitorimit të punës së OShP për nëntë (9) mujorin e punës, nga 748 ankesa të deponuara në OShP brenda kësaj periudhe, INPO ka gjetur se në njëqind

²⁹ Shih Raportin e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2022, i qasshëm në <file:///C:/Users/HP/Downloads/RAPORTI%20VJETOR%202022.pdf>

e nëntëdhjetë e katër (194) aktivitete, OShP i ka kthyer në ri-vlerësim³⁰. Në ndërkohë kjo dukuri negative vërtetohet edhe me raportin e fundit të progresit për vendin, ku thekson se nevojiten përmisime në procesin e vlerësimit të tenderve³¹.

6.5. Gjetjet tjera në fazën e tenderimit të aktiviteteve

Komuna e Dragashit për tenderin “Rregullimi i rrugës dhe infrastrukturës përcjellëse në rrugën Qupino në fshatin Brod”, përkundër nënshkrimit të Deklartates së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponeshmëris së Fondeve me datë 14.02.2023, zotimin e mjeteve e ka realizuar tek mbas publikimit të **Njoftimit mbi Vendimin e AK-së**, përkatësisht me datë 22.03.2023.

INPO ka gjetur se Komuna e Dragashit ka shpërblyer me kontratë OE i cili në listë e çmimeve për pozicione të njejta ka paraqitur çmime të ndryshme. Respektivisht punët përgaditore OE fitues në gjitha pozicionet ka ofertuar me çmimin më të ulët prej 0.10 - 0.50. Madje, për pozicionin I.4 të paramases “Cmontimi i kubezave,transporti I tyre deri ne deponine me te afert legale per hudhjen e mbeturinave te ngurta”, komuna do të paguaj 0.50, ndërsa për të njejtën punë por në pozicion tjetër, përkatësisht pozicioni I.4 tek punët përgaditore (nën (poshtë) fshati) komuna do të paguja 1.00 euro për 1 metër ²³².

Komuna e Ferizajt tek tenderi “Ritenderim II Mbarsimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtime të imëta kundër sëmundjeve clostridiale”, INPO ka gjetur se për kundër paraqitjes së pesë (5) kërkesave për rishqyrtim pranë AK-së dhe tre (3) ankesave në OShP, Komuna e Ferizajt nuk ka repektuar dispozitat ligjore për sa i përket pezullimit të aktivitetit të prokurimit. Ky AK, pezullimin e aktivitetit të prokurimit e ka bërë vetëm në dy raste, përkatësisht me datë **24.12.2022 dhe 11.01.2023**, madje as kur është deponuar ankesë me datë 24.04.2023 . Kjo situatë përbën shkelje flagrante të LPP, përkatësisht nenit 108/A i cili teksativisht thot se: “Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”, dhe nenin 112 të po të njejtit ligji “dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin kontraktues që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë”. Madje, disa kërkesa për rishqyrtim dhe vendimet ndaj saj, nuk janë fare publike.

INPO ka drejtuar pyetje në Komunen e Ferizajt lidhur me këtë çështje dhe të njejtit kanë interpretuar vet ligjin duke u përgjigjur se: “te kjo lëndë vetëm një vendim për pezullim të aktivitetit

³⁰ Për më shumë rreth punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për periudhën janar-shtator 2023, shih raportin “Shqyrtimi i Korrupsionit në Prokurim Publik”, të publikuar nga INPO, i qasshëm në: https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Raporti-i-monitorimit-te-OShP-se_06.12.2023-INPO.pdf

³¹ Për më shumë shih Raportin e Progresit për Kosovë për vitin 2023 i qasshëm, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

³² Shih kontratën e publikuar së bashku me listën e çmimeve https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2372909

është dhe nuk ka tjetër për arsye se vetëm njëherë nxirret ky vendim pasi që i njeiti operator ka bërë disa herë kërkesa për Ri-shqyrtim”³³.

Përkundër aprovimit të ankesave nga ana e OShP e cila kishte gjetur se komuna kishte vepruar në kundërshtim me ligjin duke përcaktuar kritere favorizuese dhe obligon Komunen e Ferizajt, që përmes Formularit B54 - Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të bëjë ndryshimin e kritereve, por ky AK-të vetëm i ka shtuar ato, që do të thotë se nuk janë respektuar vendimet e panelit shqyrtues³⁴.

Komuna e Gllgocit në tenderin për përfaqësim ligjor të komunes kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik më të shtrejtë, përkundër që në kriteret e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë kriter i dhënies së kontratës është çmimi më i ulët, më saktë AK të tre (3) operatorët ekonomik ofertues me çmimin më të lirë i kishte eliminuar me arsyen se “Ofërata është në kundërshtim me rregulloren për tarifen e avokatëve”, kriter të cilin nuk e ka paraparë fare në dosjen e tenderit. Pas paraqitjes së dy (2) ankesa pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit nga i njeiti OE, saktësisht “Alhena Law Office”, LLC, ku në të dyjat rastet OShP obligon Komunen e Gllgocit që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Për më tepër, Komuna e Gllgocit përkundër rivlerësimit të tenderve sipas vendimit të panelit shqyrtues, ani pse tetë (8) ditë me vonesë sipas **Vendimit PSH. 222/23** rekomandon për kontratë prap operatorin e njejtë ekonomik, Ardian I. Bajraktari B.I, operator i cili nuk i përmbushë kapacitetin teknik dhe profesional sipas kritereve e dosjes së tenderit Në ankesën e fundit të parashtuar nga ana e “Alhena Law Office”, paneli shqyrtues ka vendosur lidhur me këtë ankesë pesëdhjetë e dy (52) ditë pas paraqitjes së saj apo tetëmbëdhjetë (18) ditë më vonë sesa afati i rregullt ligjor për shqyrtim të ankesave.

INPO duke parë neglizhencën dhe vonesën në marrjen e një vendimi për këtë aktivitet të prokurimit, me datë 05.09.2023 ka parashtuar kërkesë për qasje në informacion pranë OShP-së duke kërkuar informacione se cili është statusi i kësaj ankesë përkundër që kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për marrjen e një vendimi. Bazuar mbi kërkesën për informacion të dërguar nga INPO, OShP me datë 07.09.2023, rrjedhimisht pasafatshëm publikon vendimin lidhur me këtë çështje me anë të të cilit aktiviteti në fjalë kthehet në rivlerësim dhe kërkon nga ana e Komunes së Gllgocit që brenda 5 dite të respektohet vendimi i OShP. Kësisoj, Komuna e Gllgocit me datë 12.09.2023 publikon formularin B58 - Njoftim mbi Vendimin e AK me anë të të cilit shpërblehet me kontratë “Alhena Law Office”.

Për tenderin “Turizmi i aventurës në Komunen e Pejës”, të udhëhequr nga **Komuna e Pejës**, INPO ka gjetur se komisioni vlerësues i ofertave ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk përmbushë

³³ Informacion, I siguruar më 18.07.2023, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

³⁴ Shih Vendimet e OShP për këtë tender: <https://oshp.rks.gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?RequestVerificationToken=5tCKIAgYa6Q0NYeXAGCAOurNCHSL33KO0QpcsJA3qrkLdvXdyUyTc6NBP839arrqDe8LMSkqTSLGfUFdhkIMWwYz8nm5IIEnd7slvauE3QwI&ProcurementNumber=656-22-9727-2-1-1&ContractingAuthorityId=&EconomicOperatorId=>

kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe kapacitetin teknik dhe profesional, apo opearitorin të vetëm ofertues dhe rrjedhimisht fitues. Gjetjet e INPO-s, tregojnë se “PRO PRINT SHPK” me të cilin Komuna e Pejës ka nënshkruar kontratë më 28.09.2023, në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës figuron i regjistruar më datën 23.03.2023.³⁵Ndërsa, kriter të dhënies në Dosje të Tenderit dhe Njoftim për Kontrat ishte që “Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjat tre vite të fundit financiare duhet te jet jo më pak se 350.000.00 Euro”. I njeiti OE në oferten e tij ka paraqitur listen e kontratave të realizuara me Bisnesin Individual të cilat sipas antëtarëve të komisionit vlerësues në raport të vlerësimit janë konsideruar në pajtueshmëri të plotë.

Komuna e Suharekës tek tenderi “Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen Skenderbeu - Suharekë-ritender” ka kontraktuar punë me çmime jo reale apo 45000 % më të shtrenjta se çmimi real i tregut dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) në Kosovë. Për ndërtimin e kanalizimit fekal dhe atmosferik, respektivisht për punët përgatitore në pozicionin I.I. të paramasës me paralogari “Shënimi i trases para se të fillojnë punimet dhe përcjellja gjatë ekzikutimit, stacionazha 77 – 206” komuna do të paguajë 450.00 euro për 1m . Ndërkaq, çmimi real për këtë pozicion në treg varion nga 0.50 deri në 1.00 euro për 1m²apo 45000 % më lirë se çmimi në kontratë. Po ashtu, INPO ka gjetur se në kontratë për të njëjtën punë por në stacionazhën tjetër (206 – 089) komuna do të paguajë vetëm 0.80 euro për 1m.Kësisoj, për punët e shënimit të trasesë në stacionazhën 77 – 206, komuna për 317 m do të paguaj gjithsej 142,893.60 euro, ndërkaq për 2436m në stacionazhën 206 – 089 do të paguaj gjithsej, 1,948.80 euro. Po ashtu, në paramasën me paralogari të kontratës, përseritet për së paku dy herë i njëjti përshkrim i punës, por në segmente të ndryshme, të cilat kanë çmime po ashtu të ndryshme.

Tutje, INPO ka gjetur se për projektin e ndërtimit të kolektorit, komuna kishte paraparë edhe zgjerimin e një segmenti të rrugës “Skëndërbeu” të cilën qytetarët e kishin kundërshtuar edhe përmes një peticioni në adresë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Insrastruktues (MMPHI) për shkak të cënimit të interesave të banorëve dhe bizneseve që operojnë në atë rrugë. MMPHI më 09.08.2022 përmes shkresës DMRr-622/22 ka kërkuar nga komuna e Suharekës që të anulojë projektin e zgjerimit të rrugës me arsyetimin se kjo rrugë është rrugë rajonale dhe se është kompetencë e ministrisë, mirëmbajtja dhe rikonstruimi i saj. Komuna e Suahrekës nuk i ka përfillur kërkesat e banorëve dhe as të MMPHI-së dhe ka vazhduar me procedurat e prokurimit, respektivisht lidhjes së kontratës³⁶.

Si rezultat i ndikimit të INPO-s, punimet për këtë projekt nuk kanë vazhduar edhe gjatë. Punimet janë ndërprerë nga inspektoriati i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapsinorë dhe Infrastrukturës

³⁵ Të dhënat e OE fitues të qasshme në <https://arbk.rks-gov.net/TableDetails>

³⁶ Për më shumë shih reagimin e INPO-s, <https://inpo-ks.org/komuna-e-suharekes-kontrakton-pune-45-mije-here-me-te-shtrenjte-se-cmimi-i-tregut/>

me datë 21.11.2023 dhe për këtë kontratë deri më datë 29.11.2023, komuna nuk ka ekzekutuar asnjë pagesë në drejtim të operatorit ekonomik³⁷.

7. Menaxhimi i kontratave

Menaxhimi i kontratës nënkupton fazën prej momentit të nënshkrimit të kontratës deri në implementimin e plotë të saj qoftë furnizim, shërbim apo punë dhe si i tillë konsiderohet i avancuar nëse përmbush të gjitha objektivat të cilat derviojnë nga Ligji për Prokurim Publik dhe rregullat tjera ligjore. Gjetjet e Raportit të Progresit për vitin 2022, tregojnë se në Kosovë në nivel vendi janë nënshkruar 10,290 kontrata publike në vlerë prej 559 milionë euro. Të gjitha këto kontrata të nënshkruara janë përgjegjësi e një menaxheri të kontratës i cili caktohet për secilën kontratë paraprakisht nga ZKA pas nënshkrimit të saj.

I njejtë, pra menaxheri i kontratës supozohet që të përcjellë të gjithë ecurin e implementimit të kontratës duke qenë përgjegjësi kryesor rreth përmbushjes të të gjitha obligimeve të kontratës të bazuara në kushtet e saj. Për më tepër, një menaxher i kontratës duhet të veprojë me integritet dhe përgjegjshmëri të lartë konform detyrave dhe obligimeve menaxheriale. Kjo sipas Raportit të Progresit të BE-së për të parandaluar [meqë ekziston] rrezikun e keqmenaxhimit dhe korrupsionit për shkak të zbatimit të kufizuar, llogaridhënies së pamjaftueshme menaxheriale, kontrollit të pamjaftueshëm të cilësisë dhe kapacitetit të kufizuar të menaxhimit të kontratave³⁸. Ndërsa, sipas parimeve të OECD/SIGMA mallrat, punët dhe shërbimet e prokuruar duhet të dorëzohen sipas kontratës në tërësi, ndryshimet e kontratës duhet menaxhohen në kohën e duhur dhe duke mos kufizuar konkurrencën. Për më tepër SIGMA thotë se AK-të përdorin instrumente për të krahasuar ekonominë, eficientë dhe efikasitetin e procedurave të prokurimit publik dhe për të vlerësuar zbatimin e kontratës.

7.1 Aspektet formale të menaxhimit të kontratës

Sipas Raporti Vjetor të Punës së Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, gjatë vitit 2022, në nivel vendi janë nënshkruar 10,290 kontrata publike në të gjitha AK-të në vlerë totale prej 559,017,913.90 për të tre kategorit, furnizim, shërbim dhe punë³⁹. Të gjitha këto kontrata e nënshkruara si marrëveshje kontraktuale në mes të palëve, përkatësisht në mes të OE-së dhe AK-së, e cila udhëhiqet nga kjo e fundit është e obliguar që si bartëse e procedurave të njejtën ta publikojë në platformen e eprokurimit, madje kontrata duhet të jetë e plotë përfshirë: kushtet e veçanta të kontratës si dhe ofertën e OE fituese për një kontratë të caktuar. Ligji taksativisht thekson se *“Me publikimin e njoftimit për nënshkrim të kontratës, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës do të njoftohen automatikisht nga sistemi i prokurimit elektronik për emërimet përkatëse dhe për kontratën e nënshkruar. Me publikimin e njoftimit*

³⁷ Përgjigje e siguruar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të Komunes së Suharekës.

³⁸ Për më shumë shih Raportin e Progresit për Kosovë për vitin 2023 i qasshëm, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

³⁹ Për më shumë shih Raportin Vjetor të KRPP të vitit 2022, i qasshëm në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20vjetor%202022.pdf>

për nënshkrim të kontratës, kontrata e nënshkruar do të jetë në dispozicion për shkarkim nga të gjitha palët e interesuara⁴⁰.

Bazuar në këtë dispozit ligjore e cila konsiston në transparencë dhe menaxhim të parasë publike, INPO ka monitoruar nëse AK-të respektojnë këtë obligim ligjor. Në këtë drejtim në tabelen në vijim gjeni të bashkangjitur se cilat nga komuna nuk e përmbushin këtë obligim ligjor i cili derivon nga rregullat e prokurimit publik.

(Mos)publikimi i kontratave të nënshkruara në platformen e eprokurimit		
Komuna	Titulli i kontratës	Numri i prokurimit
Deçan	Asfaltimi i rrugëve në Belle-Faza e I	631-22-6348-5-2-1
Gjilan	Ndërtimi i tregut të Gjelbërt në Komunën e Gjilanit	651-21-1775-5-1-5
Kaçanik	Rregullimi i Muzeut Kacanik	652-23-5831-5-2-1
Klinë	Regullimi i trotuarit dhe shtegut të bicikletave me infrastrukturë percjellse nga qyteti i Klinae deri te udhekrzqi Peje-Prishtine.	634-22-7768-5-2-1
Podujevë	Ndërtimi i stacionit të autobusëve	615-22-8718-5-1-1
Prizren	“Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës me asfalt në fshatin Novakë- Projekt dy vjeçar”.	622-22-9790-5-1-1
Suharekë	Projekt me bashkefinansim - Ndërtimi i mbikalimit - Hisar - Lidhja e shtigjeve të ecjes në të dy krahët e qytetit	624-22-6281-5-2-1
Shtime	Rregullimi i parkut në fshatin Davidovc -Komuna Shtime	617-22-9095-5-2-1
Viti	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik -Projekt dy vjeçar	657-21-5190-5-1-1
Vushtrri	Ndërtimi i objektit ndihmës në stadiumin - Ferki Aliu	VU644-22-8552-5-2-1

Tabela 5. (Mos)publikimi i kontratave të nënshkruara në platformen e eprokurimit

Nga të dhënat e paraqitura në tabelen më lartë vërehet qartë se nga tetëmbëdhjetë (18) komuna e monitoruara, dhjetë (10) prej tyre nuk kanë publikuar kontratën e nënshkruar në platformen e eprokurimit. Në këtë rast kemi të bëjmë me mungesë të transparencës dhe mosrespektim të dispozitave ligjore. Komuna e Gjilanit, është AK i cili kontratën e ka publikuar në platformen e eprokurimit gjysmë e cila nuk përfshin të gjitha pjesët përbërse të saj, sipas Njoftimit të datës 23.09.2022 të KRPP. Përkundër Njoftimit të KRPP-së, i cili nuk po zbatohet, zyrtarët e INPO-s këtë shqetësim gjatë fazës së monitorimit të menaxhimit të kontratave e ka ngritur edhe në takim me Kryetarin dhe Anëtarin e KRPP-së me datë 12.10.2023.

Plani i menaxhimit të kontratës dhe menaxheri i kontratës janë një tjetër aspekt formal i implementimit të kontratës në terren. Gjegjësisht, pas nënshkrimit të kontratës Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dakordohet me Njësinë e Kërkesës për emërimin e menaxherit të kontratës i cili miratimin përfundimtar e merr nga Zyrtari Kryesor Administrativ, e i njejti pas marrjes së detyres

⁴⁰ Neni 70.8 i RrPP-së, e qasshme në: https://e-prokurimi.rksgov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregulloret%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

obligohet që të hartojë planin e menaxhimit të kontratës sipas formularit C01 i cili është miratuar nga KRPP⁴¹.

Në vazhdim do të gjeni të gjitha gjetjet e INPO-s, për sa i përket monitorimit të planit të menaxhimit në tetëmbëdhjetë (18) komuna, i cili plan nuk hartohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk përmban as të dhënat bazike të kërkuara.

Komuna e Deçanit, për kontratën “*Asfaltimi i rrugëve në Belle-Faza e I*”, nuk përmban informatën se nga kush është hartuar plani i menaxhimit të kontratës, mbi të gjitha INPO për këtë kontratë ka pranuar planin e menaxhimit të pa nënshkruar nga të dyjat palët në procedurë, respektivisht, nuk figuron nënshkrimi i menaxherit të kontratës e as i menaxherit nga ana e OE-së.

Komuna e Ferizajt, planin e menaxhimit të kontratës “*Ndërtimi i objektit për insitucionin e nivelit parashkollor - Ferizaj*” është hartuar tridhjetë e gjashtë (36) ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe nuk përmban detaje të tjera përveç fillimit dhe mbarimit të kontratës duke mos përmbajtur të gjitha detajet e domosdoshme të kërkuara sipas ligjit.

Komuna e Glogocit, për kontratën “*Bashkëfinancim projektsh - riparimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre - ritenderim*”, në planin e menaxhimit të kontratës nuk përmban emrin e menaxherit të kontratës i cili e ka hartuar planin e menaxhimit të kontratës. Ndërsa, ky projekt është bashkëfinancim në mes të Komunes së Glogocit dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe nga kjo e fundit nuk posedon Vendim për Caktim të Menaxherit nga radhët e ministrisë ashtu siç parashihet në memorandumun e bashkëfinancimit dhe as PMK.

Komuna e Gjakovës, bën pjesë në mesin e komuanve të cilat nuk kanë hartuar fare PMK, përkatësisht për kontratën “*Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc*”, komuna nuk ka respektuar kërkesat ligjore.

Komuna e Kamenicës, planin e menaxhimit të kontratës “*Participimi me donatorë Ndërtimi i urës “Karaçevë e poshmtë – Breznicë”*”, e ka hartuar njëmbëdhjetë (11) ditë pas nënshkrimit të kontratës, madje i njëjti është kundërthënës për sa i përketë përfundimit të punimeve, ku në Kushtet e Veçanta të Kontratës punimet janë paraparë të përfundojnë me datë me datë 31.10.2021, ndërsa sipas PMK afati i përmbushjes së kontratës është 12.11.2021.

Komuna e Pejës, për kontratën “*Ndërtimi i objektit për qendrim të përkohshëm (Shtëpia Emergjente)*”, përkundër që përmban të gjitha detajet e tjera sipas kërkesave ligjore në planin e menaxhimit të kontratës, i njëjti është hartuar tridhjetë (39) ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Komuna e Prizrenit, tek kontrata “*Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës me asfalt në fshatin Novakë-Projekt dy vjeçar*”, të dhënat janë krejtësisht të mangta në PMK, ku nuk figuron as hartuesi i këtij plani dhe përmbanë vetë detajet e fillimit dhe afatin e përmbushjes së kontratës.

⁴¹ Shih Formularin C01 i miratuar nga KRPP, i qasshëm në <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>

Komuna e Gjilanit, Podujevës, Prishtinës, Suharekës dhe Vushtrrisë janë komuna të cilat nuk ofruar qasje në dokumente publike dhe si të tilla nuk mund të identifikohen kundërthëniet dhe gabimet eventuale të cilat mund të kenë rrjedhur nga hartimi i PMK.

Një PMK nuk mund të hartohet dhe zbatohet pa një menaxher të kontratës, kështu menaxhimi i kontratës është kuptimplotë vetëm atëherë kur udhëhiqet nga persona të cilët profesioni i tyre përkon me natyrën e kontratës. Gjetjet nga Raporti i Progresit për Kosovën 2023 për fushën e Prokurimit Publik tregojnë se “Kapaciteti për të menaxhuar proceset e prokurimit publik ndryshon ndërmjet autoriteteve kontraktuese”, ngjashëm ndodh edhe në procesin e menaxhimit të kontratave, ku përcakohen menaxher të ndryshëm të kontratës, varësisht nga lloji i saj. Në këtë drejtim, emërimi i menaxherëve të kontratës kërkon vëmendje dhe analizim paraprak të kontratës e cila do të “servohet” në menaxhim.

Duke ditur rëndësin dhe efektivitetin e menaxhimit të kontratës e cila ndikon direkt në implementimin e saj konform kërkesave ligjore, INPO ka realizuar biseda telefonike me menaxherët e kontratave të cilat i ka monitoruar për këtë raport, në atë mënyrë që të pasqyroj saktë gjendjen reale në terren. Shumicën e rasteve ndodh që caktimi i menaxherit të kontratës të jetë barrë dhe përgjegjësi jashtë detyrave kontraktuale të cilat i posedojnë. INPO bazuar në

Numri i kontratave të menaxhuara brenda vitit		
Deçan	Kreshnik Berisha	8
Ferizaj	Agim Derguti	13
Glllogoc	Vehbi Jashari	12
Kaçanik	Valmir Krasniqi	5
Kamenicë	Hasan Rapuca	3
Klinë	Arbnore Thaqi	10
Pejë	Besim Lulaj	11
Podujevë	Ismet Kadriu	14
Prizren	Ejup Kryeziu	49
Rahovec	Jetmir Ukaj	5
Shtime	Gazmend Hysenaj	14

përgjigjet e pranuar ka evidentuar se mesatarja e kontratave të cilat menaxherët e caktuar nga ZKA kanë në menaxhim është 13 kontrata. Kurse, më së shumti që një menaxher ka në menaxhim një kontratë në mesin e komunave të monitoruara është dyzet e nëntë (49) në Komunen e Prizrenit, ndërsa më së paku që ka në menaxhim është tre (3), përkatësisht në komunën e Kamenicës. Ndërsa, për Komunen e Dragashit, Gjakovës, Gjilanit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë nuk kemi të dhëna.

Tabela 6. Numri i kontratave të menaxhura brenda vitit

Të gjeturat e INPO-s, vazhdimisht tregojnë se menaxherët e kontratave janë të ngarkuar me menaxhimin e një numri të madh të tyre, e që kjo ndikon direkt edhe në performancën e tyre si menaxher si dhe në implementimin dhe realizimin e kontratës në terren e cila mund të përcjellet me vonesa të punimeve, cilësi të dobëta si dhe pranim të punimeve pa përfunduar.

7.2 Ekzekutimi i pagesave në kundërshtim me ligjin

INPO ka analizuar efikasitetin e administratës komunale sa i përket ekzekutimit të pagesave për kontratat e përzgjedhura për monitorim. Respektivisht, është analizuar nëse faturat e dorëzuara

dhe kërkesat për pagesë nga OE-të janë paguar brenda afatit 30 ditor.⁴² INPO përmes kërkesave për qasje në dokumente publike ka siguruar dokumentet e nevojshme për analizën e kësaj çështje. Komuna e Gjakovës, Kamenicës dhe Kaçanikut, nuk kanë ofruar qasje në pagesat e faturave për kontratat e zgjedhura për monitorim, përkundër që në kërkesat për pagesë të OE-ve ka ofruar qasje. Mirëpo, INPO nuk ka mundur të vlerësojë nëse faturat e OE-ve janë paguar brenda afatit ligjorë, meqenësë këto tre (3) komuna nuk kanë ofruar qasje në urdhërpagesa. Kundër kufizimit për qasje në këto dokumente ndaj këtyre komunave, INPO ka deponuar ankesa në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP).

Tutje, në pesëmbëdhjetë (15) komunat e tjera në kontratat e monitoruara të gjitha pagesat janë kryer brenda afateve ligjore të përcaktuara me rregulla financiare. Këto gjetje tregojnë se komunat kanë shënuar një përmirësim sa i përket rregullësisë së procesimit dhe shlyerjes së obligimeve të papaguara financiare. Në vitin e paraprak, INPO kishte gjetur se tetë (8) nga njëzet (20) komunat e monitoruara nuk kishin paguar obligimet financiare brenda afateve ligjore. Madje, në disa raste afatet për pagesë ishin tejkaluar me muaj të tërë.⁴³

Është inkurajuese rregullësia e AK-ve në shlyerjen e obligimeve financiare sipas rregullave për shpenzimin e parasë publike, ku përveç tjerash mbrohen burimet publike nga humbjet si rezultat i procedurave për përmbarrimin e faturave apo obligimeve të pashlyera.

7.3 Siguria e ekzekutimi të kontratës

Siguria e ekzekutimit si një obligim ligjor, i paraparë me LPP i cili taksativisht saktëson: *”Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës”* është mekanizëm i cili mund të përdoret nga AK-të që të mbaj përgjegjësi OE-të të cilët nuk kanë arritur të përfundojnë, respektivisht mospërbushin obligimet kontraktuale ashtu siç është e përcaktuar në KVK dhe PMK.

Të gjeturat e INPO-s në mënyrë sistematike tregojnë se AK-të nuk kujdesen që ky obligim ligjor të respektohet në praktikë, respektivisht që siguria e ekzekutimit të jetë valide ashtu siç përcaktohet në nenin 29.6 të rregullave për prokurim publik. E njëjta, pra siguria e ekzekutimit të kontratës në rastet kur është jovalide, nuk mund të konfiskohet në rastet kur kontrata nuk përmbushet brenda afateve të parapara kontraktuale.

Ndryshe nga viti i kaluar ku INPO kishte identifikuar se katërmëdhjetë (14) prej njëzet (20) komunave të monitoruara në kontratat e tyre siguria e ekzekutimit ka qenë jo valide, këtë vit ashtu sikurse të ekzekutimi i pagesave kemi në përmirësim sa i përket këtij aspekti. Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se nga tremëdhjetë (13) komunat e monitoruara, vetëm pesë (5) prej tyre sigurinë e ekzekutimit nuk e kanë në përputhje me kërkesat ligjore, në mesin e tyre janë: Komuna

⁴² Neni 41, Rregulla Financiare 01/2013, Ministria e Financave – Shpenzimi i parasë publike, e qasshme nw: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10203>

⁴³ Raporti *“Monitorimi i procesit të prokurimit dhe Menaxhimit të Kontratave”*, Iniciativa për Progres (INPO), Mars 2023, i qaashëm në: https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/Raport-Monitorimi-i-procesit-t%C3%AB-prokurimit-dhe-menaxhimi-i-kontratave_Mars-2023.pdf

e Deçanit, Ferizajt, Kamenicës, Klinës, Pejës, gjersa për Komunen e Gjilanit, Podujevës, Prishtinës, Suharekës dhe Vushtrrisë nuk kemi të dhëna sa i përket kësaj çështje.

Përveq rasteve të jovaliditetit të sigurisë së ekzekutimit e cila nuk dorzohet ashtu siç parashihet me ligj, e njeta edhe nga AK-të ka raste kur nuk kërkohet në përputhje me dispozitat ligjore, siç është në Komunen e Deçanit.

7.4 Gjetjet nga monitorimi në terren i implementimit të kontratave

Me qëllim të pasqyrit të sakt të gjendjes reale në implementimin e kontratave nga AK-të dhe OE-të, të dyja si palë në procedurë, INPO përgjatë viteve në procesin e monitorimit të menaxhimit të kontratave ka aplikuar metodën e vizitës në terren në vendin e implementimit të kontratës. Në shumë kontrata të monitoruara ndodhë që AK-të dhe OE-të të respektojnë të gjitha obligimet ligjore për prodhimin e dokumenteve të cilat burojnë nga LPP dhe rregullat tjera ligjore për prokurim, përfshirë raportet e menaxherit të kontratës, ekzekutimin e pagesave, raportet teknike e të tjera, ndërsa vizita në vendpunishte dëshmon të kundërten e asaj të paraqitur në letër. Kjo ndodh në rastet kur AK-të nuk pranojnë furnizimin, shërbimin apo punën e kontraktuar sipas përshkrimit në pozicione të paramases dhe jo vetëm. Në bazë të Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF– Shpenzimi i Parave Publike, për tu ekzekutuar një pagesë nevojiten këto dokumente *“Kërkesa për blerje/zotimi; Kopja e kontratës që është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit si kopje autentike e origjinalit; Urdhër blerja; Raporti i pranimit; Urdhër pagesa; Fatura origjinale”*⁴⁴.

Në këtë drejtim, INPO në vazhdim ka paraqitur të gjitha gjetjet gjatë monitorimi dhe analizimit të procesit të menaxhimit të kontratave në tetëmbëdhjet (18) komunat e monitoruara. Përkitazi me menaxhimin e kontratave burojnë edhe gjetjet të cilat kryesisht ndërlidhen me pranim dhe ekzekutim të pagesave për punë të papërfunduara, mospërmbushje e kontratës brenda afateve të përcaktuara kontraktuale si dhe pothuajse të gjitha kontratat e monitoruara shoqërohen me cilësi të dobëta të punimeve, rrjedhimisht kjo dëshmon dhe papërgjegjshmërinë e AK-ve dhe OE-ve ndaj parasë publike të cilat supozohen të ndikojnë direkt në mirëqenien e qytetarëve.

Komuna e Deçanit

Në Komunen e Deçanit, INPO ka monitoruar kontratën *“Asfaltimi i rrugëve në Belle-Faza e I”* për të cilën vizita në terren është realizuar më 16.11.2023, kontratë e cila është përcjellur me vonesa në implementimin e saj përkundër se e njeta është 3 vjeçare. Për këtë kontratë të nënshkruar me datë 03.08.2023, OE tek tani ka hasur në largim të drunjëve, sipas pozicionit 1.2 të paramases. INPO në terren ka evidentuar ekzekutim të pagesave në vlerë totale 50,000 euro në dhjetor të

⁴⁴ Për më shumë, shih nenin 26 të Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10203>

vitit 2022 për tre akse, 1, 3 dhe 4, për punët që tani po realizohen në terren, rrjedhimisht një vitë me vonesë.



Fotografia 1. Punët në terren janë duke vazhduar



Fotografia 2. Shtresa e betonit e cila rrezikon të shembet

Ashtu siç shihet në fotografinë 1, punimet e realizuar nga OE gjenden ende në fazën fillestare, përkatësisht gjerrmimin e dheut dhe largimin e drunjëve. Ndërsa, në fotografinë 2 mbushja është bërë mbi shtresën e betonit (kufizimit) nga e cila rrezikohet të shembet, e cila dëshmon cilësi të dobët të punimeve.

Komuna e Dragashit

INPO më datë 01.12.2023 ka realizuar viziten në terren për kontratën “Rregullimi i amfiteatrit në rrugën Kroj i xhamis në fshatin Bellobrad”. Kjo kontratë është e njëjtë me atë të vitit 2021, madje në platformën e prokurimit janë të paraqitura të njëjtat skica sikurse në vitin 2021. Kjo kontratë përfshinë realizimin e punimeve në po të njëjtën objekt të cilën INPO e ka monitoruar gjatë vitit 2022/23, saktësisht komuna e Dragashit ka lidhur kontratë të re për projektin të cilin INPO ka evidentuar raste të ekzekutimit të pagesave pa pranimit të punëve, përkatësisht pa u realizuar fare punët e kontraktuara dhe degradim të objektit⁴⁵.

INPO të njëjtat gjetje i ka identifikuar edhe në viziten në terren me datë 01.12.2023. Përkundër nënshkrimit të kontratës për realizimin dhe përfundimin e projektit, amfiteatri ka mbetur i papërfunduar, që do të thotë në raport me nënshkrimin e kësaj kontrate të re nuk ka pasur ndonjë përparim në realizim të tyre.

⁴⁵ Për më shumë, shih raportin e INPO-s “Monitorimi i procesit të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave” i qasshëm në https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/Raport-Monitorimi-i-procesit-t%C3%AB-prokurimit-dhe-menaxhimi-i-kontratave_Mars-2023.pdf



Fotografia 3: Monitorimi i datës 24.10.2022



Fotografia 4. Monitorimi i datës 01.12.2023

Në fotografinë 3 dhe fotografinë 4 mund të vërehet qartë realizimi dhe ekzekutimi i kësaj kontrate. Fotografitë më lartë dëshmojnë që OE nuk ka përfunduar punimet sipas kontratës së nënshkruar, madje në drejtim të OE-së janë ekzekutuar pothuajse të gjitha pagesat, mbetja totale e realizimit të pageses është 4,220 euro. Në këtë drejtim, INPO ka gjetur se Komuna e Dragashit kontratën për rregullimin e amfiteartit e ka nënshkruar me datë 14.12.2022, ndërsa OE ka dozruar faturat pranë AK-së në vlerë prej 15,000 euro me datë 20.12.2022 apo më saktë gjashtë (6) ditë pas nënshkrimit të kontratës, rrjedhimisht Komuna e Dragashit ka ekzekutuar 75% të pagesës në afat rekord pranë OE-së, gjersa punët në terren dëshmojnë të kundërten. Tutje, sipas paramases, përkatësisht pozicionit I.2.1, OE është i obliguar që të bëjë pastrimin e terrenit, në ndërkohë INPO në terren ka gjetur një mori mbetjesh të cilat nuk janë larguar fare nga OE fitues.

Komuna e Ferizajt

Vizita në terren për kontratën e monitoruar në Komunen e Ferizajt, është realizuar me datë 17.11.2023. Kontrata e monitoruar në këtë komunë është “Ndërtimi i objektit për institucionin e nivelit parashkollor”. Kontrata e lartëpërmendur është kontratë e monitoruar edhe gjatë vitit 2022 nga INPO. Përkundër që punimet është dashur të përfundojnë me datë 20.11.2023, gjendja në terren është po thuhet e njëjtë sikurse në vitin 2022, kur INPO kishte raportuar për këtë kontratë⁴⁶. Madje, shumë pak progres është shënuar, përkundër që AK ka lëshuar dy vrejte në drejtim të OE-së duke kërkuar planifikim të fillimit të punimeve⁴⁷.

⁴⁶ Për më shumë, shih raportin e INPO-s “Monitorimi i procesit të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave” i qasshëm në https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/Raport-Monitorimi-i-procesit-t%C3%AB-prokurimit-dhe-menaxhimi-i-kontratave_Mars-2023.pdf

⁴⁷ Shih Vërejtjet e AK-së ndaj OE-së të qasshme në https://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1174254



Fotografia 4. Monitorimi dates 17.11.2023



Fotografia 5. Objekt i demoluar

INPO gjatë vizitës në terren përveq që nuk ka hasur në ndonjë përparim sa i përket realizimit të punimeve, ashtu siç vërehet në fotografinë 4, ka hasur gjithashtu edhe në dëshmi që prona po përdoret për qëllime të tjera, siç janë drutë e vendosura në po të njejtën fotografi, madje INPO ka hasur se kjo hapsirë e cila parashihet të shndërrohet në çerdhe po përdohet si parking nga qytetarët. Ndërsa, në fotografinë 5 pasqyrohet objekti i demoluar, i cili përkundër përfundimit të punëve të betonit punët rrezikohen të dëmtohen për shkak të mos izolimeve dhe dëmtimit nga natyra.

Komuna e Glllogocit

Në Komunen e Glllogocit, për kontratën “*Bashkëfinancim projektesh - riparimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre - ritenderim*”, vizita në terren është realizuar me datë 28.11.2023. Për këtë kontratë, duke ditur që është bashkëfinancim në mes të komunes së Glllogocit dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, sipas memorandumit të bashkëfinancimit të nënshkruar në mes dy palëve është paraparë që projekti të përfundojë brenda vitit 2022. Faturat e pranuar nga dy palët dëshmojnë se punimet kanë përfunduar në dhjetor të vitit 2022, mirëpo gjetjet e INPO-s tregojnë se punët e përfunduara janë përcjellur me cilësi të dobët të punimeve.

Nga 17 pritoret e realizuara sipas paramases, INPO ka monitoruar 7 prej tyre në fshatra të kësaj komune, në të gjitha këto janë hasur cilësi e dobët e punimeve, dëmtimi i tyre nga reshjet e shiut, mosrealizim i punimeve përkundër ekzekutimit të pagesave.



Fotografia 6. Sankoc: Dëmtimi i ulësëve nga reshjet shiu.



Fotografia 7. Damanek: Ulëset e dëmtuara dhe pa xham.

Pra, në fotografinë 6 shihet qartë se si pasojë e cilësisë së dobët dhe reshjeve të shiut është dëmtuar ulësja e pritores. Ndërsa, në fotografinë 7 shihet mungesa e xhamit të pritores dhe rrjedhimisht edhe dëmtimi ulëses së pritores të cilën INPO e ka hasur në disa fshatra, ngjashëm sikurse rrjedhjen e ujit atmosferik mbi këto pritore.

Komuna e Gjakovës

Në Komunen e Gjakovës vizita në terren është realizuar më 20.11.2023 për kontratën “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc” të impementuar nga kjo komunë.

Gjetjet e INPO-s për këtë kontratë janë shqetësuese, përkundër që AK-të në drejtim të OE-së ka ekzekutuar të gjitha pagesat në vlerë prej 34,373.35 euro. Fillimisht, INPO për këtë kontratë ka hasur në vështirësi të identifikimit të këtij lokacioni dhe monitorimin e projektit. Madje, as vet qytetarët nuk janë në dijeni për ekzistencën e këtij shtegu. Së dyti, vizita në terren dhe punimet e përfunduara nuk përkojnë fare me paramasën dhe kontratën e nënshkruar. Ashtu siç shihet në fotografinë 8 dhe 9, punimet në terren nuk përkojnë me një shteg të bicikletave e as të ecjes. INPO ka identifikuar cilësi të dobët të punimeve, lënie në gjysmë të tyre.



Fotografia 8. “Shtegu i bicikletave dhe ecjes”



Fotografia 9. Ulëset dhe shporta të dëmtuara

Ndër të tjerash, INPO ka evidentuar edhe punë në kundërshtim me paramasen dhe cilësi të dobët të furnizimit nga ana e OE-së. Ulëset dhe shportat e mbeturinave tek punët e tjera, përkatësisht pozicioni 1 dhe 2 i paramases janë kërkuar “Ulëset nga materiali i fortë dhe i përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme”, në ndërkohë fotografia 9 dëshmon saktë gjendjen e tyre. Meqë projekti dhe pagesat kanë përfunduar, INPO ka kërkuar qasje në raportin e pranimit teknik, ndërsa nga komuna e Gjakovës kemi pranuar këtë përgjigje: “për projekte të kësaj natyre nuk aplikohet ndonjë raport për pranim teknik”.

Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit është në mesin e komunave të cilat nuk kanë ofruar qasje në dokumente publike për kontratën e monitoruar, megjithatë INPO për kontratën “Ndërtimi i tregut të Gjelbërt në Komunën e Gjilanit” me datë 23.11.2023 ka realizuar vizitë në vendin e implementimit të kontratës. Gjatë vizitës në terren kemi identifikuar cilësi të dobët të punimeve ndërsa për shkak të mungesës së faturave dhe pagesave nuk mund të evidentohen detajet të tjera.



Fotografia 10. Cilësi e dobët e punimeve



Fotografia 11. Shndrrimi i pjesës së restaurantit në zyre të tregut

Gjatë vizitës në terren janë identifikuar cilësi e dobët e punimeve nga ana e OE-së, kjo dëshmohet në fotografinë 10. Ndërsa, në fotografinë 11 vërehet ndërtimi i disa zyreve të cilat sipas tregëtarve po shndërrohen në zyre të tregut, ndërsa kjo pjesë sipas projektit është paraparë të shndërrohet në restaurant. Tutje, OE edhe përkundër përfundimit të projektit në tërësi, i njëjti nuk ka bërë pastrimin e terrenit sipas paramases dhe nënshkrimit të kontratës. Kurse, rrëfimet e tregëtarëve tregojnë për kushtet e vështira në treg, ky treg nuk posedon nxemje dhe drita dhe në momentin kur nxemjet ndizen, energjia elektrike dobësohet dhe nalet.

Komuna e Kaçanikut

Në Komunën e Kaçanikut, vizita në terren është realizuar më 29.11.2023 për kontratën: “Rregullimi i muzeut Kacanik”. Sa i përket kësaj kontrate, nga vizita në terren është gjetur se kontrata nuk ka përfunduar ende edhe pse e njëjta është dashur të përfundoj, meqë është nënshkruar me datë 15.08.2023 dhe të përfundoj brenda 30 dite. Pra, punët janë në vazhdim e sipër dhe gjatë vizitës INPO nuk ka hasur në puntorë aty.

Ashtu siç mund të vërehen në fotografinë 12, INPO ka gjetur se OE ka bërë furnizimin me tavolina sipas pozicionit 1.5 dhe 1.6 e ka realizuar me tavolina të plasaritura. Ndërsa, në foton 13 vërehen punimet të cilat po vazhdojnë ende në muzeun.



Fotografia 12. Tavolina të plasaritura



Fotografia 13. Punimet në vazhdim e sipër

Tutje, Komuna e Kaçanikut për këtë kontratë në listen e çmimeve/paramasën, përkatësisht pozicionin 1.1 të paramasës ka kërkuar TV LED, SAMSUNG, ndërsa sipas ligjit përcaktimi i specifikimeve teknike të cilat i referohen një produkti janë të ndaluara.

Komuna e Kamenicës

Vizita në terren në Komunen e Kamenicës është realizuar me datë 23.11.2023, për kontratën e implementuar nga kjo komunë “Participimi me donatorë Ndërtimi i urës “Karaçevë”, kontratë e implementuar në tërësi sipas raportit të pranimit të punimeve të datës 30.11.2021. Megjithatë INPO gjatë vizitës në terren ka hasur pranim të punëve të realizuar në kundërshtim me paramasën dhe paralogarinë.



Fotografia 14. Punët në kundërshtim me paramasën



Fotografia 15. Cilësi e dobët e punimeve dhe mbeturina

Në fotografinë 14, INPO gjatë vizitës në terren ka evidentuar punët e pranuar dhe pagesa të realizuara në kundërshtim me paramasen, përkatësisht pozicionin 7.3, “Furnizimi me material dhe vendosja e kubëzave të trotuarit për këmbësor me trashësi t-8cm”. Përkundër që për këtë pozicion është realizuar pagesa në tërësi, INPO në terren nuk ka identifikuar kubëza betoni në trotuar, mirëpo e njëjta është shtruar me beton. Ndërkaq, fotografia 15 dëshmon cilësinë e dobët të punimeve dhe terrenin e papastuar.

Komuna e Klinës

Në Komunën e Klinës vizita në terren është realizuar me datë 16.11.2023 për kontratën “Regullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhekryqi Pejë-Prishtinë. Nga vizita në terren është gjetur se kontrata ende është duke u implementuar nga kjo komunë. Gjatë implementimit të kësaj kontrate në terren, INPO ka evidentuar një numër shkeljesh të cilat do të pasqyrohet tutje përmes fotografive.



Fotografia 16. Punë të demoluara



Fotografia 17. Punët e papërfunduara


Ashtu siç mund të vërehet në fotografinë 16 dhe 17 janë identifikuar punë të demoluara dhe të papërfunduara nga OE, për të cilat Komuna e Klinës ka ekzekutuar pagesat në drejtim të OE-s. Gjatë vizitës në terren, INPO në terren ka evidentuar vetëm 4 ulëse me mbështetëse, ndërsa sipas paramasës përkatësisht pozicionit 1.1.4 kërkohen 5 sosh, në vlerë totale prej 1,250.00 euro. Kurse, gjatë vendosjes së shportave të mbeturinave, OE nuk ka përdorur një standart të vendosjes së tyre, mirëpo disa janë të vendosura edhe në pronë private. Për sa i përket sistemit të ujitjes, sipas pozicionit 1.1.6 të paramasës, i njëjti nuk ka mundur të identifikohet në të gjitha rastet për shkak të vendosjes së gurëve mbi dhe.

Komuna e Pejës

Konform monitorimit dhe menaxhimit të kontratave, INPO viziten në terren në Komunen e Pejës e ka relizuar me datë 16.11.2023 për kontratën “Ndërtimi i objektit për qendrim të përkohshëm (Shtëpia Emergjente)” për të eventuar dhe identifikuar punimet e realizuara gjatë implementimit të kontratës. Data e përfunimit të kësaj kontrate është 31.12.2023, ndërsa punimet të realizuara dhe identifikuar në terren tregojnë se përmbyllja e saj brenda afatit, është pothuajse e pamundur, ndërkaq INPO nuk ka hasur puntorë në vendpunishte.



Fotografia 18. Dera e vendosur në kundërshtim me paramasë ekzekutiv



Fotografia 19. Punët e realizuara pa përfillur projektin

Në fotografinë 18, argumentohet se dera e vendosur në shtëpin e emërgjences nuk përkon me paramasën tek punët e zdruktarsisë - dyer dhe dritare, përkatësisht pozicionin I.00 “furnizimi dhe montimi i dyerve të hyrjes kryesore duhet të jenë nga materiali i përpunuar dhe përfilluar që mundëson sigurim blind (blinduara), ndërsa në fotografinë 19 vërehet se punët e dritareve nuk përkojnë me projektin ekzekutiv të komunes së Pejës për këtë kontratë⁴⁸. Pra, zbrastira ndërmjet dritares dhe betonit të pllakës II dhe III, do të duhej të ishte muratuar me kohë. Tutje, INPO ka gjetur se punët për fasadim dhe ngjyrosjes janë ekzekutuar pagesat në drejtim të OE-së, në ndërkohë punimet janë ende të pa përfunduara.

Komuna e Podujevës

⁴⁸ Për më shumë shih Projektin Ekzekutiv për “Ndërtimi i objektit për qendrim të përkohshëm (Shtëpia Emergjente), i qashtëm në https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2031476

Komuna e Podujevës ka refuzuar qasje në dokumente publike për kontratën “Ndërtimi i stacionit të autobusëve”, të implementuar nga kjo komunë. Përkundër kësaj, INPO ka realizuar vizitën në terren me datë 29.11.2023 për të parë gjendjen e punimeve dhe realizimin e projektit. Mirëpo, përkundër nënshkrimit të kontratës me datë 13.12.2022, punimet gjenden ende në fazën fillestare e të cilat do të duhej të përfundonin në gusht të vitit 2023.



Fotografia 20. Shënimi i trases së autobusve



Fotografi 21. Punimet në terren janë duke u realizuar

Përgjatë vizitës në terren, përkundër që punimet do të duhej të përfundonin, INPO i ka hasur në implementim të kontratës, ashtu siç vërehen në fotografinë 20 dhe 21. Përkundër tejkalimit të afatit kontraktual për përmbushjen e saj, monitoruesit e INPO-s, nuk kanë hasur në puntorë në vendpunishte përveq makinerive të OE-ve. INPO nuk ka mundur të evidentoj dhe identifikoj ekzekutimet e pagesave ndaj OE-së për shkak të kufizimit të qasjes në dokumente publike.

Komuna e Prishtinës

Në Komunën e Prishtinës, vizita në terren është realizuar me datë 19.12.2023, përkatësisht për kontratën “Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore Nëna Terezë -RITENDER”, kontratë e cila është vazhdim i monitorimit nga kontrata paraprake “Ndërtimi i shkollës Nënë Tereza në Vranidoll”, për të cilën INPO kishte publikuar gjetjet në raportin e vitit 2023⁴⁹. Ndryshe nga viti i kaluar, ku INPO kishte evidentuar punë të papërfunduara për shkak të ndërprerjes së kontratës, këtë vit projekti është finalizuar dhe implementuar kontrata në tërësi.



Fotografia 22. Objekti i përfunduar



Fotografia 23. Pemët nuk janë vendosur sipas paramases

⁴⁹ Për më shumë, shih raportin e INPO-s “Monitorimi i procesit të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave” i qasshëm në https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/Raport-Monitorimi-i-procesit-t%C3%AB-prokurimit-dhe-menaxhimi-i-kontratave_Mars-2023.pdf

INPO gjatë vizitës në terren ka identifikuar se projekti i mbetur në gjysëm me lidhjen e kontratës së re pas disa ritenderimeve ka arritur të finalizohet në tërësi, madje i njëjti është funksionalizuar në tërësi ashtu siç vërehet në fotografinë 22. Mirëpo, për shkak që objekti ka qenë i mbyllur pas përfundimit të procesit INPO nuk ka arritur të monitoroj objektin mrenda. Ndërsa, gjatë realizimit të vizitës, monitoruesit e INPO-s, në terren kanë gjetur se përkundër që në pozicionin e I.1.8 35 të paramases është paraparë që të vendosen 70 drunjë dekorativ, INPO në terren ka gjetur 44 pemë të vendosura, mirëpo për shkak të kufizimit të qasjes në dokumente publike, INPO nuk ka arritur të evidentoj pagesat e realizuara në drejtim të këtij pozicioni.

Komuna e Prizrenit

Në Komunen e Prizrenit, vizita në terren për mbikqyrje në implementim të kontratës “Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës me asfalt në fshatin Novakë- Projekt dy vjeçar” është realizuar me datë 01.12.2023. Lidhur me këtë kontratë gjatë vizitës në terren janë gjetur kryesisht punime jocilësore dhe të papërfunduara.

Përkundër që implementimi i kontratës nuk ka përfunduar nga kjo komunë, meqë sipas PMK parashihet të përfundoj me datë 17.06.2024, INPO ka hasur në cilësi të dobëta të punimve, mbetje të materialit punues në rrugë, si dhe puseta të hapsura pa shenja informuese të cilat konsiderohen të rrezikshme ashtu siç pasqyrohen në fotografinë 24 dhe fotografinë 25.



Fotografia 24. Ura tek “Villa Palushi” nuk është shtruar ende.



Fotografia 25. Puseta me material metal


Tutje, për këtë kontratë e cila ende nuk është implementuar në tërësi, Komuna e Prizrenit ka nënshkruar ankes kontratë me datë 05.09.2023, i cili aneksë përfshinë pothuajse të njëjat pozicione sikurse në paramasen dhe kontratën bazë.

Komuna e Rahovecit

Në Komunen e Rahovecit, INPO me datë 21.11.2023 ka realizuar vizitë në terren për kontratën “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec” të implementuar nga kjo komunë. Kjo kontratë e cila sipas marrëveshjes kontraktuale do të duhej të përfundonte me datë 14.04.2023, nuk është

implementuar në tërësi përkundër që kanë kaluar 250 ditë nga kur është dashur të përfundoj si projekt.

Për këtë projekt janë ekzekutuar pothuajse 90% e pagesave në drejtim të OE-së përkundër që punët në teren nuk janë realizuar. INPO sipas paramases dhe parallogarisë ka identifikuar punë të ndryshme nga ajo çka është paraparë sipas obligimeve kontraktuale siç është rasti tek punët e gletit dhe fasadës, përkatësisht pozicionin 9 të listës së çmimeve ku thuhet “furnizimi dhe ekzekutimi i gletit të të gjitha mureve të brendshme dhe pllafoneve në objektin e lokaleve”, ndërkaq INPO në terren ka identifikuar vetëm pllafonin me glet ndërsa muret e fasaduara, ku mund ti shihni në fotografinë 26.



Fotografia 26. Fasadimi i objektit në vend të gletit



Fotografia 27. Ekzekutimi i pagesave pa përfunduar punët

Ndërkaq, në fotografinë 27 janë të paraqitura evidentimi dhe identifikimi i mospërfundimit të punimeve për kundër që afati ligjor për përmushjen e kontratës ka tejkaluar, kësaj nga kjo mund të konkludohet në një menaxhim jo të duhur të kontratës dhe joprofesional.

Pas realizimit të vizitës në terren dhe dërgimit të raportit të INPO-s për komente nga komuna, Drejtori për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm z. Erhan Morina vonesat e implementimit të projektit i ka arsyetuar për shkak të kushteve atmosferike. Ndërsa, sa i përket ndryshimit të pozicionit 9, i njeti ka deklaruar se “ky pozicion ka qenë i paraparë të relizohet me glet, por njësisia e kërkesës bashkë me nenaxherin e kontratës, në konsultë me ingxhinierët e komunës, ky pozicion është realizuar me fasadë ngase është cilësuar se gleti është material i ndjeshëm dhe për lokale komerciale ky material dmtohet lehtë. Prandaj pllafoni është bërë me glet sepse nuk i ekspozohet prekjeve dhe dëmtimeve ndërsa muret janë bërë me fasadë ngase fasada është material më i qëndrueshëm”.

Komuna e Suharekës

Në kuadër të procesit të menaxhimit të kontratave, INPO në Komunen e Suharekës ka përzgjedhur për monitorim kontratën “Projekt me bashkefinansim - Ndertimi i mbikalimit - Hisar - Lidhja e shtigjeve te ecjes ne te dy krahet e qytetit”, e cila ndërlidhet me kontratën e monitoruar

gjatë vitit 2022 nga INPO për të cilën gjetjet janë paraqitur në raportin e vitit 2023⁵⁰. Përkundër që Komuna e Suharekës nuk ka ofruar qasje në dokumente publike për këtë kontratë, INPO ka realizuar vizitë në vendin e implementimit të kontratës, madje gjetjet do të pasqyrohen përmes fotografive.



Fotografia 28. Cilësi e dobët e punimeve



Fotografia 29. Rrëshitja e dheut


Kontrata e cila është nënshkruar me datë 12.08.2022 dhe supzohet të përfundojë brenda 90 dite, është përcjellur me cilësi të dobëta të punimeve, punë të pa përfunduara, rrëshqitje të dheut, terren i pa pastruar si dhe mbetjet e furnizimeve të OE-së, ashtu siç mund të vërehet në fotografinë 28 dhe 29. Komuna e Suharekës nuk ka ofruar qasje në faturat dhe pagesat e realizuara konform kësaj kontrate, kështu nuk mund të identifikohen dhe evidentohen pagesat e ekzekutuara konform punimeve të përfunduara.

Komuna e Shtimes

Implementimi i kontratës “Ndërtimi i parkut në Davidoc”, është udhëhequr nga Komuna e Shtimes për të cilën, INPO vizitën në terren e ka realizuar me datë 17.11.2023. Punimet e kësaj kanë përfunduar përpara përfundimit të afatit përfundimtar sipas kontratës për implementimin e saj, mirëpo edhe ky projekt është përcjellur me cilësi të dobëta të punimeve.



Fotografia 30. Dëmtimi i karrigeve nga lagështia dhe mosnevizilim i duhur



Fotografia 31. Ekzekutimi i pagesave pa pranuar punët

⁵⁰ Për më shumë shih gjetjet e aktivitetit “Ndërtimi i shëtitores Lagjja e bajraktarëve Suharekë”, në Raportin “Monitorimi i procesit të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave” i qasshëm në https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/Raport-Monitorimi-i-procesit-t%C3%AB-prokurimit-dhe-menaxhimi-i-kontratave_Mars-2023.pdf

Nga fotografitë e paraqitura më lartë, vërehet qartë cilësia e punimeve në këtë park, përkatësisht fotografia 30 përcakton mosnevilizimin e duhur të parkut i cili ka shkaktuar edhe grumbullim të ujrave pas reshjeve të shiut, ndërsa situatë e ngjashme paraqitet edhe tek fusha. Ndërsa, në fotografinë 31, përkundër ekzekutimi të pagesave për pozicionin 9, Gjelbrimi të paramases, INPO nuk ka hasur në lule të mbjellura nga OE. Kësisoj, ekzekutimi i pagesave në raport me mospërfundimin e punimeve, konsiston në ekzekutim të tyre në formë të kundërligjshme. Tutje, INPO ka evidentuar edhe cilësi të dobët në gypat e vendosur të cilët dalin nga pompa për ujitje dhe gropa të rrëzikshme afër bunareve.

Komuna e Vitisë

INPO me datë 23.11.2023, ka realizuar vizitën në terren për implementimin e kontratës “Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik - Projekt dy vjeçar” të udhëhequr nga Komuna e Vitisë. Kjo kontratë e nënshkruar me datë 27.10.2021 nuk ka arritur të implementohet në tërësi sipas afateve të përcaktuara kontraktuale e cila është paraparë të përfundoj më 25.10.2023.

Kjo kontratë, sipas paramases përmban një numer të madhë të lokacioneve për ndërtimin e trotuareve, ndriçimin publik, rregullimin e parkingjeve tek stadiume si dhe shteg të bickletave. Në këtë drejtim, INPO ka përzgjedhur disa lokacione ku ka monitoruar procesin e punimeve. Saktësisht, lokacionet e përzgjedhura janë: Trotuari, ndriçimi publik dhe parkingu tek stadiumi në Pozheran, trotuari në Ramjan, trotuari dhe ndriçimi publik në Smirë.

Përkundër që punët është dashur të përfundojnë në muajin tetor të vitit 2023, INPO në fshatin Pozheran, përkatësisht rr.”Zeqë Pira” nuk ka hasur fare në trotuar të ndërtuar, madje nuk monitorusit nuk kanë hasur as në puntor të OE fitues në këtë pjesë, ashtu siç shihet në fotografinë 32. Madje, Komuna e Vitisë nuk ka ofruar qasje në të gjitha faturat dhe pagesat e ekzekutuara në drejtim të OE-së, kësijoj INPO nuk ka mundur të identifikoj të gjitha detajet e pagesave.



Fotografia 32. Mungesa e trotuarit në Pozheran



Fotografia 33. Punimet në rr.”mbi Përmendore”, Ramjan

Ndërsa, në fotografinë 33, INPO gjatë vizitës në terren në rr. “Hysni Salihu” ka hasur në puntor të OE fitues duke gërmuar dheun dhe ndërtimin e trotuarit në këtë pjesë, përkundër tejkalimit të afateve ligjore për përmbushjen e saj. Tutje, në fshatin Smirë, përkatësisht në punimet e trotuarit në rr. “Hysni Salihu”, INPO gjatë monitorimit ka hasur në cilësi të dobët të punimeve, mbetje të materialeve, ndërsa për të gjithë kontratën totali i pagesave të pranuar nga Komuna e Vitisë është 90,000 euro të realizuara në drejtim të OE-së kryesisht për punët përgaditore.

Komuna e Vushtrrisë

Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies vije në shprehje edhe nga Komuna e Vushtrrisë, e cila komunë ka kufizuar qasjen në dokumente publike për kontratën “Ndërtimi i objektivave në stadiumin Ferki Aliu”. Përkundër kësaj, INPO ka vazhduar në përmbushjen e objektivave dhe qëllimet e monitorimit, duke realizuar vizitën në terren me datë 27.11.2023. Gjatë vizitës në terren është evidentuar cilësi e dobët e punëve, ndërsa për shkak të mungesës së faturave dhe pagesave ka qenë e vështirë të identifikohen detaje më konkrete rreth implementimit të kësaj kontrate.



Fotografia 34. Punët jo cilësore



Fotografia 35. Punimet e përfunduara të cilat janë dëmtuar

Ashtu siç shihen në fotografinë 34 dhe 35, kjo kontratë dhe implementimi i saj janë përcjellur me cilësi të dobëta të punimeve, punime të pa planifikuara si dhe dëmtimi i tyre ende pa u përmbushur në tërësi kontrata. INPO për shkak të mungesës së faturave dhe pagesave nuk mund të identifikoj se cilat pozicione janë paguar në drejtim të OE-së.

8. Gjetjet kryesore

- Dymbëdhjet (12) nga tetëmbëdhjetë (18) tender të monitoruar në tetëmbëdhjetë (18) AK në fazën e inicimit të akvitetëve të prokurimit nuk kanë hartuar specifikime teknike të detyrueshme sipas nenit 28 të Ligjit për Prokurim Publik.
- Komunitat pohojnë se informatat rreth specifikimeve teknike të detyrueshme gjenden në paramasë dhe listë të çmimeve, gjersa shpesh herë ato janë të paqarta, diskriminuese dhe të pa definuara kështu duke cënuar cilësinë dhe efikasitetin e prokurimit.
- Në shumicën e komunave, nuk është e identifikueshme autorësia e hartues/it/eve të specifikimeve teknike të detyrueshme.
- Në Komunën e Deçanit hartues i specifikimeve teknike të detyrueshme autor është vet OE fitues.
- INPO ka pranuar përgjigje për autorin/en e specifikimeve teknike vetëm nga Komuna e Kamenicës dhe e Shtimës, Komuna e Gjakovës dhe e Prizrenit janë përgjigjur se njësisia e kërkesës është hartues i tyre, ndërsa Komuna e Pejës dhe Podujevës kanë refuzuar të përgjigjen.
- Krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit kemi një ngritje sa i përket inicimit të aktivitetëve pa planifikim. Gjetjet e hulumtimit tregojnë se nëntë (9) nga tetëmbëdhjetë (18) komunitat e monitoruara kanë inicuar tender të paplanifikuar, respektivisht Komuna e Ferizajt, Glogocit, Gjakovës, Gjilanit, Kaçanikut, Klinës, Pejës, Shtimes dhe Vushtrrisë.
- Komuna e Ferizajt, Gjilanit, Kaçanikut, Kamenicës, Klinës, Prishtinës, Rahovecit, Vitisë dhe Vushtrrisë në dosje të tenderëve kanë vendosur kërkesa shumë të larta, jo proporcionale, diskriminuese dhe jo valide.
- Kërkesa shumë të larta, jo proporcionale, diskriminuese dhe jo valide në Dosje të Tenderëve kanë aplikuar edhe Komuna e Glogocit, Gjilanit, Shtimes dhe Vushtrrisë, mirëpo pas reagimeve dhe rekomandimeve të INPO-s, të njëjtat janë larguar nga dosjet e tenderëve.
- Komuna e Ferizajt, Glogocit, Gjilanit, Gjakovës, Kamenicës, Klinës, Pejës, Suharekës dhe Vitisë kanë shkurtuar afatet për pranimin e tenderëve në kundërshtim me dispozitat ligjore gjatë zhvillimit të aktivitetëve të prokurimit për vitin 2023.
- Komuna e Gjilanit, Kamenicës, Pejës, Podujevës, Prizrenit, Rahovecit, Shtimës dhe Vitisë në komisione të vlerësimit kanë vendosur persona, profesionistë të cilëve nuk përputhet me natyrën e tenderit.
- Komuna e Deçanit, Gjilanit, Kaçanikut, Klinës, Podujevës, Prizrenit, Suharekës, Shtimes, Vitisë dhe Vushtrrisë përkundër dispozitave ligjore dhe njoftimeve të vazhdueshme të KRPP-së nuk i kanë publikuar kontratat e nënshkruara në platformën e eprokurimit.
- Komuna e Deçanit, Ferizajt, Glogocit, Gjakovës, Kamenicës, Pejës dhe Prizrenit nuk kanë hartuar Planin e Menaxhimit të Kontratës ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore.

- Mesatarja e kontratave që menaxherët e caktuar me vendim të ZKA - së kanë në menaxhim janë 13 kontrata brenda vitit. Më së shumti që një menaxher ka në menaxhim një kontratë në mesin e komunave të monitoruara është dyzet e nëntë (49) në Komunen e Prizrenit, ndërsa më së paku që ka në menaxhim është tre (3) në Komunen Kamenicës.
- Nga trembëdhjetë (13) komunat e monitoruara, pesë (5) prej tyre sigurinë e ekzekutimit nuk e kanë në përputhje me kërkesat ligjore, saktësisht Komuna e Deçanit, Ferizajt, Kamenicës, Klinës, Pejës. Gjersa për Komunen e Gjilanit, Podujevës, Prishtinës, Suharekës dhe Vushtrrisë nuk kemi të dhëna
- Në Komunën e Dragashit, Ferizajt, Gjakovës, Kamenicës, Pejës dhe Shtime janë evidentuar pagesa pa pranuar furnizimin, shërbimin apo punën sipas kushteve të kontratës.
- Komuna e Kaçanikut në listën e çmimeve ka vendosur kritere të cilat i referohen vetëm një produkti, një gjë e tillë sipas ligjit është e ndaluar.
- Në 95 % të komunave të monitoruara të gjitha pagesat janë kryer brenda afateve ligjore të përcaktuara me rregulla financiare. Këto gjetje tregojnë se komunat kanë shënuar një përmirësim sa i përket rregullësisë së procesimit dhe shlyerjes së obligimeve të papaguara financiare.
- Në përgjithësi në të gjitha komunat ku është zhvilluar vizita në terren është evidentuar menaxhim i dobët i kontratave, posaçërisht lidhur me punë të cilësisë së dobët, lënje e punëve në gjysmë, zvarritje e punëve, e kështu me radhë.
- Komuna e Podujevës, Prishtinës, Suharekës dhe Vushtrrisë në kundërshtim Ligjin për Qasje në Dokumente Publike nuk ka ofruar qasje në dokumentet e tenderëve të kërkuara sipas kërkesave për qasje në dokumente publike, ndërsa Komuna e Gjilanit ka ofruar përgjigje të pjesshme.

9. Rekomandimet

- Komuna e Deçanit, Dragashit, Ferizajt, Glllogocit, Gjilanit, Kaçanikut, Klinës, Prishtinës, Rahovecit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë të sigurohen që hartojnë specifikime teknike të detyrueshme konform dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 28 të Ligjit për Prokurim Publik, në Dosjen e Tenderit.
- Autoritetet Kontraktuese të sigurohen se specifikimet teknike hartohen nga personat adekuat dhe AK-të të verifikojnë se produkti plotëson kërkesat dhe specifikimet e publikuara.
- Komuna e Ferizajt, Glllogocit, Gjakovës, Gjilanit, Kaçanikut, Klinës, Pejës, Shtimes dhe Vushtrrisë të sigurohen se iniciojnë tender në përputhje të plotë me planin e prokurimit.
- Komuna e Ferizajt, Gjilanit, Kaçanikut, Kamenicës, Klinës, Prishtinës, Rahovecit, Vitisë dhe Vushtrrisë të kujdesen se në dosje të tenderëve nuk vendosin kërkesa shumë të larta, jo proporcionale, diskriminuese dhe jo valide të cilat nuk përputhen me natyrën e tenderit.
- Komuna e Ferizajt, Glllogocit, Gjilanit, Gjakovës, Kamenicës, Klinës, Pejës, Suharekës dhe Vitisë të sigurohen se afatet ligjore për pranim të tenderve të jenë në përputhje me kërkesat ligjore.
- Komuna e Gjilanit, Kamenicës, Pejës, Podujevës, Prizrenit, Rahovecit, Shtimës dhe Vitisë në komisione të vlerësimit të tenderëve të sigurohen se emërojnë persona kompetent dhe profesional ashtu siç obligohen me ligj dhe profesioni i tyre të përputhen me natyrën e prokurimit të caktuar qoftë furnizim, shërbim apo punë.
- Komuna e Deçanit, Gjilanit, Kaçanikut, Klinës, Podujevës, Prizrenit, Suharekës, Shtimes, Vitisë dhe Vushtrrisë të sigurohen se respektojnë dispozitat ligjore dhe njoftimet e KRPP-së për publikimin e kontratave në platformen e eprokurimit.
- Komuna e Deçanit, Ferizajt, Glllogocit, Gjakovës, Kamenicës Pejës dhe Prizrenit të sigurohen se Planin e Menaxhimit të Kontratës e hartojnë konform dispozitave ligjore.
- Komunat të mos sigurohen se nuk ngarkojnë menaxherët me numër të madh të kontratave nën menaxhim sepse duke vepruar kështu rrezikohet implementimi dhe menaxhimi i kontratës në terren duke marrë për bazë numrin e madh të tyre në menaxhim.
- Komuna e Deçanit, Ferizajt, Kamenicës, Klinës dhe Pejës të sigurohen se sigurinë e ekzekutimit të kontratës e pranojnë në përputhje me kërkesat ligjore.
- Komuna e Dragashit, Ferizajt, Gjakovës, Kamenicës, Pejës dhe Shtimës të sigurohen që nuk ekzekutojnë pagesa pa pranuar furnizimin, shërbimin apo punën e kontraktuar.
- Autoritet Kontraktuese të mos lejojnë dhe pranojnë punë me cilësi të dobët dhe në kundërshtim me specifikat e kontratës të cilat ndikojnë edhe në dështim të një furnizimi, shërbimi apo pune të kontraktuar.

- Autoritet Kontraktuese të sigurohen që të gjithë zyrtarët e involvuar në procesin e udhëheqjes së procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave të përmbushin standartet e larta profesionale për njohuri, zbatim në praktik dhe integritet.
- Komuna e Gjilanit, Podujevës, Prishtinës, Suharekës dhe Vushtrrisë të rrisin transparencën dhe llogaridhënien dhe mbi të gjitha të respektojnë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

10. ANEKS: Tenderët e monitoruar

Komuna e Deçanit		
Inicim	Ndërtimi i fshatit turistik Podi i Gështenjave - Faza e II	631-23-1099-5-2-1
Menaxhim	Asfaltimi i rrugëve në Belle - Faza e I	631-22-6348-5-2-1
Komuna e Dragashit		
Inicim	Rregullimi i rrugës dhe infrastrukturës përcjellëse në rrugën Qupino në fshatin Brod	621-23-921-5-2-1
Menaxhim	Rregullimi i amfiteatrit në rrugën Kroji xhamis në fshatin Bellobrad (projekt dy vjeçar) - (RITENDERIM)	621-22-13026-5-2-1
Komuna e Ferizajt		
Inicim	Ritenderim II Mbarsimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve clostridiale	656-22-9727-2-1-1
Menaxhim	Ndërtimi i objektit për insitucionin e nivelit parashkollor - Ferizaj	656-20-3960-5-1-1
Komuna e Glllogcit		
Inicim	Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit	611-23-1507-2-1-1
Menaxhim	Bashkfinancim projektesh - riparimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre - ritenderim	611-22-7025-5-2-1
Komuna e Gjakovës		
Inicim	Shërbimet e konsulencës për përmirësim të shërbimeve në Komunën e Gjakovës	632-23-3834-2-2-1
Menaxhim	Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc	632-20-1308-5-2-1
Komuna e Gjilanit		
Inicim	Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan Ri Tender	651-23-9254-5-1-1
Menaxhim	Ndërtimi i tregut të Gjëlbert në Komunën e Gjilanit	651-21-1775-5-1-5
Komuna e Kaçanikut		
Inicim	Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriqimit publik në rrugë Murat Lika , Strazhë	652-23-2430-5-2-1
Menaxhim	Rregullimi i Muzeut Kacanik	652-23-5831-5-2-1
Komuna e Kamenicës		
Inicim	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra Shipashnicë, Karaqevë, Busavatë, Kopërnice, Koretin dhe Topanice-Ritenderim 2	KM653-23-7865-5-2-1
Menaxhim	Participimi me donatorë Ndërtimi i urës "Karaqevë e poshmtë – Breznicë"	KM653-21-4073-5-2-1
Komuna e Klinës		
Inicim	Hartimi i projekteve zbatuese.	634-23-9571-2-2-1
Menaxhim	Regullimi i trotuarit dhe shtegut te bicikletav me infrastruktur percjellse nga qzteti i Klines deri te udhekrzqi Peje-Prishtine.	634-22-7768-5-2-1
Komuna e Pejës		
Inicim	Turizmi i aventures ne Komunen e Pejes	635-23-9465-5-2-1

Menaxhim	Ndërtimi i objektit për qendrim të përkohshëm (Shtëpia Emergjente)	635-22-7092-5-2-1
Komuna e Podujevës		
Inicim	Ngritja e infrastrukturës së turizmit	615-23-1023-5-2-1
Menaxhim	Ndërtimi i stacionit të autobusëve	615-22-8718-5-1-1
Komuna e Prishtinës		
Inicim	Demontimi, Transporti dhe deponimi i Azbestit nga objektet publike	616-23-2785-2-2-1
Menaxhim	Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore Nëna Terezë - RITENDER	616-23-3871-5-2-1
Komuna e Prizrenit		
Inicim	Hartimi i planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit	622-23-6784-2-2-1
Menaxhim	“Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës me asfalt në fshatin Novakë-Projekt dy vjeçar”,	622-22-9790-5-1-1
Komuna e Rahovecit		
Inicim	MBIKËQYRJA E INVESTIMEVE KAPITALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim	623-23-7605-2-2-1
Menaxhim	NDËRTIMI I LOKALEVE AFARISTE ZEJTARE NË RAHOVEC	623-22-12234-5-2-1
Komuna e Suharekës		
Inicim	Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen Skenderbeu - Suharekë-ritender	624-23-4641-5-1-1
Menaxhim	Projekt me bashkefinansim - Ndertimi i mbikalimit - Hisar - Lidhja e shtigjeve te ecjes ne te dy krahjet e qytetit	624-22-6281-5-2-1
Komuna e Shtimes		
Inicim	Furnizim me farë hibride të misrit	617-23-1184-1-2-1
Menaxhim	Rregullimi i parkut në fshatin Davidovc-Komuna Shtime	617-22-9095-5-2-1
Komuna e Vitisë		
Inicim	Hartimi i projekteve investive (kapitale) për komunën e Vitisë	657-23-322-2-1-1
Menaxhim	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik - Projekt dy vjeçar	657-21-5190-5-1-1
Komuna e Vushtrrisë		
Inicim	Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës	VU644-23-8311-2-2-1
Menaxhim	Ndërtimi i objktit ndihëmës në stadiumin Ferki Aliu	VU644-22-8552-5-2-1



Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar ne vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështje sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe 2. Edukimi Demokratik.

 +383 (0) 49 354 000

 info@inpo-ks.org

 www.inpo-ks.org

